

6

# VITE PUNË

Në jetësimin e Akitit Përfundimtar të Helsinkit



TEDREJTATENJERI UTDHE DEMOKRACIPERTEGJITHE!

# FALËNDERIME



**OSCE**  
Mission in Kosovo

6 vjet punë për jetësimin e Akit Përfundimtar të Helsinkit

*Publikim i Misionit të OSBE-së në Kosovë*

Redaktorë:

Sven Lindholm, Zëdhënës, Nikola Gaon, Zyrtar i Lartë për Marëdhënie me Publikun

Fotografitë:

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Lubomir Kotek

Dizajni dhe faqosja:

Shpend Kada dhe Fisnik Kastrati

Bashkëpunëtorë:

Christopher Decker, Jose Arraiza, Melissa Stone, Michael Frahm, Michael Schuetz, Radostina Nedeva, Susana Martins, Annett Gerber, Bujar Maxhuni, Jaime Valles, Mohamed Sagdati, Jonathon Milligan, Matthew Minns, Zilha Nurkollari, Ardian Spahiu, Hasan Sopa, Alexandra Simpson, Franklin DeVrieze, Katja Salsback, Angela Tenbruck, Milosava Banašević, Ženeta Mujić, Nderim Pasuli, Aurelie Hugot, Mitchell Moran


Në mënyrë të veçantë falënderojmë Kujtim Rahmani, Mevlýde Salihun, Fatime Lepajën, Danijela Mitić, Slaviša Mladenović, Edita Buçajn dhe Armend Tahirsylajn për durimin dhe ndihmën e tyre në përkthim dhe korrekturë

OSCE HQ Prishtinë

Tel: +381 38 500 162 Fax: +381 38 500 188

E-mail: [press.omik@osce.org](mailto:press.omik@osce.org)

<https://www.osce.org/kosovo>



# HYRJE

## Struktura e publikimit

Të nderuar lexues,

Ky publikim ofron një përbledhje të punës së Misionit të OSBE-së në Kosovë gjatë gjashtë viteve të fundit. Aty poashtu flitet për historikun e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë që nga miratimi i Aktit Përfundimtar të Helsinkit deri në themelimin e Misioneve të para në Ish-Jugosllavi, dhe shpjegon kontekstin më të gjërë në të cilin funksionon Misioni i saj në Kosovë.

I ndarë në tetë kapituj tematik, ky publikim ilustron rolin që ka Misioni në ofrimin e ndihmës për të normalizuar situatën, dhe për të krijuar kushte të favorshme për mirëqenje sociale dhe ekonomike të popullit të Kosovës.

Ky dokument paraqet zhvillimet në lidhje me punën e Misionit të OSBE-së në mënyrë mjaft të detajizuar. Publikimi gjithashtu flet edhe për një numër programesh dhe projekteve kryesore, të cilat sillen nga krijimi dhe zhvillimi i institucioneve publike e deri te krijimi i plan-programeve për të drejta të njeriut për nxënësit e shkollave fillore, dhe trajnimin e policisë.

Shpresojmë se do të kënaqeni duke e lexuar këtë tekst dhe në të njëjtën kohë do të njiheni më mirë me Misionin tonë. Nëse ky publikim nuk kënaq nevojat tuaja për informim si dhe interesimin tuaj, ju inkurajmë të na kontaktoni.

*Misioni i OSBE-së në Kosovë  
Zyra për Shtyp dhe Informim Publik*

*Selia e OSBE-së në Prishtinë*

*Tel: +381 38 500 162*

*Fax: +381 38 500 188*

*E-mail: press.omik@osce.org  
https://www.osce.org/kosovo*

## Përbajtja

Hyrje nga Ambasadori Werner Wnendt .....	4
Struktura e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe bashkëpunimi në mes të shtyllave .....	5
Tridhjetë vite të Aktit Përfundimtar të Helsinkit dhe gjashtë vite të Misionit të OSBE-së në Kosovë .....	6
<b>Avancimi i të d</b>	<b>10</b>
Sigurimi i së drejtës në gjykim korrekt në Kosovë – Monitorimi i sistemit juridik .....	10
Eksperët e të drejtave të njeriut në kuadër të policisë .....	11
Përforcimi i së drejtës pronësore në Kosovë .....	12
Rrugë e gjatë deri te zbatimi i ligjit kundër diskriminimit .....	12
<b>Përkrahja e sundimit të ligjit</b>	<b>14</b>
Zbatimi i ligeve të Kuvendit të Kosovës .....	14
Institucioni i Ombudspersonit .....	15
Instituti Gjyqësor i Kosovës .....	16
Qendra Juridike e Kosovës – përmirësimi i shkathtësive ligjore .....	16
Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike .....	17
<b>Përkrahja e shoqërisë civile</b>	<b>18</b>
Dialogu qytetar .....	18
Ura qytetare .....	19
Rrjeti multietnik i grave .....	20
Programi për edukim demokratik .....	21
<b>Të rinjtë</b>	<b>22</b>
Kuvendet rinore .....	22
Mësimi plotësues dhe projekt për vetëdijësimin e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve .....	23
Ruga Sesam .....	24
Edukimi për të drejtat e njeriut .....	25
<b>Edukimi dhe zhvillimi i policisë</b>	<b>26</b>
Policia dhe komuniteti .....	26
Mbrojtja e së drejtës për të protestuar .....	27
Është realitet – Femrat po sjellin ndryshime .....	28
<b>Qeverisja e mirë</b>	<b>29</b>
Iniciativa për Mbështetjen e Kuvendit – IMK .....	29
Nga trajnimet e OSBE-së deri në Institutin e Kosovës për Administratën Publike .....	30
Fillimet e qeverisjes komunale .....	31
Zhvillimi lokal .....	31
Duke dëgjuar qytetarët .....	32
<b>Zhvillimi dhe përkrahja e mediave</b>	<b>33</b>
KOSMA .....	34
Policia dhe mediat .....	34
Radio-Televizioni shumëetnik Herc arrin në mënyrë të suksesshme deri te komunitetet .....	35
<b>Zgjedhjet</b>	<b>36</b>
Shtim i përgjegjësive për vendorët në mbajtjen e zgjedhjeve .....	36
Forumi i Zgjedhjeve shënon fazë të re të dorëzimit të përgjegjësive .....	37
Organet vendore administrojnë zgjedhjet në nivel lokal .....	38
<b>Roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë në vitin 2006</b>	<b>39</b>

**Werner Wnendt, Shef i Misionit të OSBE-së**

Në vitin 2005, OSBE-ja ka shënuar 30-vjetorin e Aktit Përfundimtar të Helsinkit. Kjo marrëveshje e miratuar nga Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) më 1 gusht të vitit 1975, ka inicuar dialogun në mes Lindjes dhe Perëndimit; duke ofruar me këtë, bazën për një Evropë më të bashkuar dhe më të sigurt.

Përmes konferencës, marrëveshja ka ndihmuar në uljen e tensioneve dhe mosbesimit në mes të shteteve dhe, së fundit, ka luajtur rol në përfundimin e Luftës së Ftoftë, ndërsa i ka kontribuar në masë të madhe edhe paqes dhe ndërtimit të demokracisë. Tridhjetë vjet më vonë, kjo marrëveshje ende udhëheq punën tonë.

Para dhjetë vitesh, KSBE-ja u transformua në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Kjo e bëri atë më operative dhe i mundësoi të jetë aktive në vendet e konfliktit.

Gjatë këtij transformimi, OSBE-ja është ballafaquar me disa sfida të vërteta. Ndërto, më e dukshmja ka qenë shpërbërja e Jugosllavisë dhe e Bashkimit Sovjetik. Sidoqoftë, gjatë gjithë kësaj periudhe, OSBE-ja ka ndihmuar në parandalimin e konflikteve potenciale dhe ka punuar me qeveritë për të ndihmuar stabilizimin dhe demokratizimin e shoqërive.

Për fat të keq, konfliktet si ai në Kosovë, nuk ka qenë e mundur të parandalohen me mjete politike. Megjithatë, duke qenë e angazhuar për siguri njerëzore, në fillim OSBE-ja, ka punuar për uljen e tensioneve dhe zgjidhjen e konflikteve, ndërsa tani punon për rehabilitim post-konfliktual.

Për Misionin e OSBE-së në Kosovë, zgjidhjet post-konfliktuale kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Ne i kryejmë këto detyra si pjesë e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara dhe shërbejmë si Shtylla e III-të.

Duke ndjekur Aktin Përfundimtar të Helsinkit dhe Mandatin tonë, aktivitetet e OSBE-së në Kosovë sillen nga trajnimi i policisë dhe ngritja e kapaciteteve në sektorin qeveritar dhe joqeveritar, deri te zhvillimi i mediave dhe organizimi i zgjedhjeve. Të gjitha këto aktivitete janë të drejtuara kah krijimi i kushteve normale për jetesë, për të gjithë qytetarët e Kosovës.


Këto kushte përfshijnë vende të punës dhe qasje në shërbimet publike si p.sh. shkollimi dhe kujdesi shëndetësor; por të gjitha këto kërkojnë një shoqëri që përkrah parimet demokratike ku mbrohen të drejtat e njeriut dhe ku sundon ligji.

Prandaj, Misioni ynë, është këtu për të punuar me popullin e Kosovës dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, për të krijuar themelët e një shoqërie të sukseshme.

Pas më shumë se gjashtë vitesh të punës sonë dhe 30 viteve të miratimit të Aktit Përfundimtar të Helsinkit, ne kemi dashur të shohim se çfarë është bërë deri më tani dhe cilat janë sfidat para nesh, edhe duke pasur parasysh faktin se procesi për të definuar statusin e ardhshëm të Kosovës ka filluar. Ky publikim e bën këtë brenda kufizimeve dhe mundësive të veta dhe nënvizon aftësinë e OSBE-së për t'iu përshtatur sfidave të ditës.

Përmes fjalëve dhe fotografive të këtij publikimi, shpreso se do të arrini t'i çmoni përpjekjet e OSBE-së, si 'Shtylla për Ndërtimin e Institucioneve' e UNMIK-ut, për të ndihmuar popullin e Kosovës që të ketë të ardhme më të sigurt. Duhet më shumë punë për të arritur këtë qëllim dhe OSBE-ja është e gatshme që të përkrahë politikanët dhe institucionet e Kosovës që janë përgjegjëse për të ardhmen e njerëzve.

Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë partnerët tanë për përkrahjen e tyre, në veçanti Përfaqësuesin Special të OKB-së, Soren Jessen-Petersen. Po ashtu falenderoj stafin e Misionit të OSBE-së për punën e tij zellshme, me çka në mënyrë të veçantë ndihem krenar.



# Struktura e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe bashkëpunimi në mes të Shtyllave

Misioni i OSBE-së është themeluar me 1 korrik të vitit 1999, me një vendim të OKB-së dhe OSBE-së, si pjesë integrale por e veçantë e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Struktura e përbërë prej katër shtyllave është struktura e parë e tillë e themeluar nga OKB-ja. OKB-ja është përgjegjëse për Polici dhe Drejtësi, ose Shtylla e I-rë, dhe Administratë Civile, që ka qenë Shtylla e II-të deri vonë. OSBE-ja, apo Shtylla e III-të, është përgjegjëse për ndërtimin e institucioneve dhe për rindërtim ekonomik, Shtylla e IV-të është përgjegjësi e Bashkimit Evropian.

E ngarkuar me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë, Misioni i OSBE-së merret me çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e institucioneve vendore – Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) – në nivel qendror dhe komunal; zhvillimin e sektorit të shoqërisë civile dhe mediave; zhvillimin e përgjithshëm të sektorit ligor dhe të praktikave qeveritare në pajtim me të drejtat e njeriut; edukimin dhe zhvillimin e policisë; si dhe administrimin e zgjedhjeve, detyrë kjo që është në proces të transferimit te vendorët.

Struktura aktuale e Misionit përfshin katër departamente:

Departamentin e Demokratizimit;


Departamentin e të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit;

Departamentin e Edukimit dhe Zhvillimit të Policisë dhe

Departamentin e Zgjedhjeve.

Secili departament ka ekpertizë në fushat e tyre të punës dhe menaxhojnë programet e tyre. Misioni poashtu ka një numër zyra të mbarë Kosovën për të punuar me institucionet dhe popullatën në nivel lokal. Sidoqoftë, përgjegjësia e plotë për udhëheqjen dhe aktivitetet e Misionit bie mbi Departamentin e Shefit të Misionit, i cili ofron udhëzime për të gjitha aktivitetet.

Departamenti i Administratës, në anën tjetër, përkrah funksionimin e Misionit dhe aktivitetet e saj.



## Bashkëpunimi në mes të Shtyllave


Në strukturën e shtyllave, aktivitetet e Misionit koordinoohen me partnerët e saj në UNMIK.

Misioni bashkëpunon me Shtyllën e I-rë për çështje që kanë të bëjnë me polisinë dhe punën e gjykatave.

Bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Civile – e cila kohëve të fundit ka dalë nga Shtylla e II-të – përqendrohet në çështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë në të gjitha nivelet e administratës publike.

Shtylla e IV-të është partner i Misionit në fushat e zhvillimit lokal ekonomik.

Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara drejton bashkëpunimin në mes të shtyllave, për tu siguruar se aktivitetet e tyre plotësojnë njëra-tjetërën dhe nuk përsëriten.



# Tridhjetë vjet të Aktit Përfundimtar të Helsinkit dhe gjashtë vjet të Misionit të OSBE-së në Kosovë

## *Historia dhe arsyet e përfshirjes së OSBE-së*

të re[]

Konferanca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) u mbajt në korrik të vitit 1973 në Helsinki, Finlandë. Pasuan dy vjet me negociata diplomatike, që sollën aprovimin e Aktit Përfundimtar të KSBE-së, me 1 gusht të vitit 1975, nga kryetarët e 35 vendave pjesëmarrëse. Ishte vendi ku u mbajt kjo ceremoni - një urë në mes Lindjes dhe Perëndimit - që i dha emrin Aktit Përfundimtar të Helsinkit.

### Parimet themelore

Akti Përfundimtar hapi një proces që ka kontribuar në stabilizimin, në fazë të ndryshme, të raporteve në mes të shteteve pjesëmarrëse në konferencë, dhe rivendosjen e marrëdhënieve miqësore në mes të Lindjes dhe Perëndimit. Kjo konferencë caktoi dhjetë parime themelore, të cilat do të rregullonin raportet në mes të shteteve pjesëmarrëse.



Vendimi për të transformuar KSBE-në në OSBE është marrë në Samitin e Budapestit, në dhjetor të vitit 1994 nga kryetarët e shteteve anëtare.

Këto parime themelore përfshinin:

1. Barazinë soviane (shtetërore), respektimin e të drejtave të garantuara me sovranitet;
2. Përbajtjen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës;
3. Pacënueshmërinë e kufijve;
4. Integritetin territorial të shteteve;
5. Zgjidhjen paqësore të konfliktave;
6. Mosndërhyrjen në punët e brendshme;
7. Respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale, duke përfshirë lirinë e të menduarit, vetëdijes, fesë apo besimit
8. Të drejta të barabarta dhe vetëvendosje për popujt;
9. Bashkëpunim në mes të shteteve dhe
10. Përbushje në mirëbesim të obligimeve që dalin nga ligji ndërkombëtar.

Me nënshkrimin e Aktit Përfundimtar, shtetet pjesëmarrëse kanë marrë përsipër obligimin që të respektojnë dhe zbatojnë se cilët nga këto dhjetë parime.

Negociatat diplomatike që u mbajtën para dhe pas miratimit të Aktit Përfundimtar të Helsinkit, çuan në hapjen e perdes së hekurt, krijimin e një rajoni ekonomik më të integruar, një sërë çarmatimesh dhe bashkëpunim ushtarak, shkëmbim të informatave, programe të përbashkëta shkencore dhe programe përmbrojtje të ambientit, si dhe respekt më të madh të të drejtave të njeriut.

### Transformimi i Konferencës në Organizatë

Me kalimin e viteve, puna e Konferencës po bëhej gjithnjë e më e strukturuar. Në nëntor të vitit 1990 vendet pjesëmarrëse nënshkruan Kartën e Parisit për një Evropë të Re, duke i bërë thirrje KSBE-së që të angazhohet në mënyrë aktive në menaxhimin e ndryshimeve pas Luftës së Ftohtë.

Roli kryesor i KSBE-së ishte të shërbente si një mekanizëm për parandalimin e konfliktave, përzgjidhjen e konfliktave dhe rehabilitim pas konfliktit.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, KSBE-ja krijoj institucione të përhershme dhe siguroi aftësi operacionale. Në Samitin e Budapestit, në dhjetor të vitit 1994, vendet pjesëmarrëse erdhën në përfundim se Konferencia që moti ishte bërë më shumë se një konferencë dhe se emri i saj duhej të ndryshonte për të pasqyruar nevojat aktuale dhe realitetin. Ata vendosën ta shndërronin Konferencën në Organizatë, dhe kështu lindi Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

### Misionet e para

Duke iu përgjigjur shpërbërjes së Jugosllavisë dhe përhapjes së luftrave në ish-republikat e saj, KSBE-ja dërgoi Misionet e saj të para afatgjata në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë, në vitin 1992. Qëllimi i këtyre Misioneve ishte monitorimi i zhvillimeve të sigurisë, kërkimi i mënyrave për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut dhe informimi i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së (i përbërë nga ambasadoret e shteteve pjesëmarrëse në OSBE). Misionet u mbyllën një vit më vonë, pasi që autoritetet jugosllave nuk e miratuan qëndrimin e mëtutjeshëm.

Jostabiliteti politik dhe konfliktet gjatë viteve në vijim bënë që OSBE-ja të themelohet aktivitete fushore (misione dhe zyra) në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Shqipëri, Kosovë, Jugollavi (më vonë e ri-emëruar Unioni Serbi dhe Mali i Zi) në Evropën jug-lindore; Estoni, Letoni, Moldavi, Ukrainë dhe Bellorusi në Evropën Lindore; në Armeni dhe Azerbejxhan në Kaukaz; dhe Taxhikistan, Turkmenistan, Uzbekistan, Kirgistan dhe Kazakistan në Azinë Qëndrore.



Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup ka qenë operacioni i dytë fushor i themeluar nën KSBE-në në vitin 1992. Ai ka monitoruar kufinjtë përmes paralajmëruar dhe parandaluar përhapjen e konfliktit.

## Shtetet pjesëmarrëse në vitin 1975:

Austria, Belgjika, Bullgaria, Kanada, Qipro, Çekoslovakia, Danimarka, Finlanda, Franca, Republika Demokratike e Gjermanisë, Republika Federale e Gjermanisë, Greqia, Vatikani, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Lichtenstajni, Luksemburgo, Malta, Monako, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, San Marino, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Jugosllavia.

Gjithsejt 35 shtete.

## Vendet e reja anëtare

Shumica e këtyre misioneve janë themeluar në shtete të reja – 18 nga to (me përjashtim të Misionit në Kosovë) – të krijuara me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Të gjitha këto shtete u bënë vende anëtare të OSBE-së, duke mundësuar kështu vendosjen e misioneve apo zyreve në territoret e tyre, si dhe zbatimin e parimeve të OSBE-së.

Me ndarjen e Republikës Çeke dhe Sllovake, bashkimin e Gjermanisë, si dhe përfshirjen e Lituanisë, Shqipërisë dhe Andorës në OSBE, Organizata tashmë numëron 55 vende dhe aktualisht është e njohur si organizata më e madhe evropiane për siguri.

## Roli i Organizatës

Qëllimi i organizatës është parandalimi i konfliktive në rajonet e vendeve anëtare – nga Vankuveri në Kanada e deri në Vladiivostok të Rusisë. Në raste kur kjo nuk është e mundur apo mungon vullneti politik, Organizata angazhohet për zgjidhje të konfliktit. Hapi i fundit që ndërmerr Organizata është rehabilitimi pas konfliktit.

Varësisht nga mandati me të cilin duhet të pajtohet vendi nikoqir i misionit, (në rastin e Kosovës, kjo është bërë në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e cila ka themeluar Administratën e Përkohshme të OKB-së në këtë territor), puna e misioneve dhe zyreve të OSBE-së mund të përfshijë tri dimensione – dimensionin njerëzor, ekonomik dhe të ambientit, si dhe dimensionin politiko-ushtarak.

## Institucionet

Për të siguruar njohuri mbi aktivitetet fushore dhe për të krijuar ekspertizë në fusha të caktuara të punës apo çështje specifike, KSBE-ja filloj të themelojë institucionë të cilat përbëjnë pjesë të përherësime të strukturës së OSBE-së: Zyrën për Institucionë Demokratike dhe të Drejta të Njeriut, Përfaqësuesin e OSBE-së për Liri të Mediave, Komisionerin e Lartë për Pakica Kombëtare, Sekretariatin me aktivitete të parandalimit të konfliktive, terrorizmit, trafikimit, aktivitete për ekonomi dhe ambient, si dhe njësitet për çështje të policisë. Në nivel politik, Organizata udhëhiqet nga Kryesuesi i Radhës – që është Ministër i Punëve të Jashtme i shtetit që kryeson Organizatën gjatë një viti - që fillon çdo janar.


## Kosova

### Historiku

Përkeqësimi i situatës së sigurisë në ish-Jugosllavi kërkoi angazhimin e KSBE-së në pajtim me obligimet që i ishin besuar në Samitin e Parisit (1990). KSBE-ja veproi për të ndalur përhapjen e mëtujeshme të konfliktit, duke përdorur të gjitha mjetet politike në dispozicion.

Hezitim i autoriteteve jugosllave për të bashkëpunuar me KSBE-në çoi në suspendimin e anëtarësisë së saj në Konferencë, me 8 korrik të vitit 1992 (suspendimi zgjati më shumë se sa që ishte pritur fillimi i përfundoi me 7 nëntor të vitit 2000).

*Flamujt e 55 shteteve anëtare janë të vendosur në hyrjen e qendrës për konferenca në Hofburg, Vjenë, qyteti ku ndodhet selia e Këshillit të Përherëshëm të OSBE-së.*



## HISTORIKU

Në shtator të vitit 1992, Misione afatgjata u vendosën në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë, si dhe Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup.

Në vitin 1992, regjimi jugosllav me ngurrim pranoi të ketë vëzhgues të paanshëm të KSBE-së në territorin e vet. Detyra e tyre ishte të mbikëqyrin gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të ofrojnë sugjerime përmirësimin e saj. Ata, po ashtu, ndodheshin aty për të ndihmuar dialogun në mes të popujve nga këto tri rajone me organet qeveritare. Kur Jugosllavia refuzoi të vazhdojë mandatin e Misioneve, ata u tërroqën në qershori të vitit 1993.

Që nga ajo kohë e deri në themelimin e Misionit Verifikues në Kosovë (KVM) në tetor të vitit 1998, OSBE-ja është përfshirë në disa negociata diplomatike me qëllim të uljes së tensioneve dhe përmirësimit të kushteve të jetesës për popullatën vendore.

Në këtë kontekst, në mars të vitit 1998, Këshilli i Përherëshëm i OSBE-së, me vendimin e marrë për të përkrahur misionin e ri të z. Felipe Gonzalesit si Përfaqësues Personal i Kryesuesit të Radhës për Republikën Federale të Jugosllavisë, deklaroi se kriza në Kosovë nuk është vetëm çështje e brendshme për shkak të shkeljeve të parimeve dhe zotimeve të OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe sepse ndikonte seriozisht në sigurinë rajonale. Këshilli i Përherëshëm po ashtu bëri thirrje për kthimin e Misioneve Afatgjata në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë.

Para kësaj, z. Gonzales kishte qenë në një mision në Jugosllavi për të vlerësuar çështjet që kishin të bënin me zgjedhjet, si legjitimiteti i tyre dhe sjellja e mediave.

KVM – Misioni i parë i OSBE-së i themeluar për të përkrahur Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së – kishte për qëllim të verifikonte respektimin e armëpushimit, të monitoronte lëvizjen e trupave dhe të promovonte të drejtat e njeriut.

Edhe këtë herë, OSBE-ja kishte rol operacional në Kosovë dhe verifikuesit e saj të paarmatosur ishin shumë aktiv për ta ndërprerë konfliktin dhe për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut. Puna ditore e KVM-së ka përfshirë aktivitetet siç janë: monitorimi i lëvizjes së trupave, ndihma për refugiatët dhe të plagosurit, negocimi i armëpushimeve dhe lirim i pengjeve.

Palët në konflikt shpesh nuk ishin të kënaqura me qëndrimet e pakompromis të OSBE-së, të artikuluara kohë pas kohe në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut. OSBE-ja poashtu instistonte në implementim e plotë të marrëveshjeve që autoritetet jugosllave kishin nënshkruar me OSBE-në. Si rezultat, verifikuesit e Misionit, rrëth 1,400 meshkuj dhe femra, në disa raste edhe u keqtrajtuan apo edhe u vunë në pozitë me rrezik për jetën e tyre.

Gjatë misionit të saj të shkurtër, KVM-ja është përpjekur të ngrisë zërin kundër abuzimeve të të drejtave të njeriut nga forcat ushtarake dhe policore jugosllave, si dhe nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Këto abuzime përfshinin sulmet, kërcënimet, shkatërrimin e pronës, grabitjen dhe marrjen peng, si dhe dëbimin.

Për shkak të këtyre përpjekjeve, në janar të vitit 1999, Kryesia e Radhës e OSBE-së e konsideroi si të papranueshëm deklarimin e Shefit të KVM-së „persona non grata“ nga autoritetet jugosllave dhe i ofroi Misionit përkrahje të plotë së bashku me Këshillin e Përherëshëm të 54 vendeve anëtare (anëtarsia e Jugosllavisë në OSBE ishte ende e suspenduar në atë kohë).

Megjithatë, me përkeqësimin e situatës dhe me përfundimin e bisedimeve për paqe në Rambouillet në mars të vitit 1999, Kryesuesi i Radhës i OSBE-së, Ministri norvegjez i punëve të jashtme Knut Vollebaek, vendosi që të tërheq verifikuesit ndërkombëtarë të OSBE-së nga Kosova.



Në situatat më ekstreme, aksionet ushtarake në vitin 1999 kanë përfunduar me humbje të jetërave.



Konflikti në Kosovë ka lënë shumë prona të shkatërruara. Me qindra familje kanë humbur shtëpitë e tyre dhe janë detyruar të gjejnë strehim në vende tjera.

KVM-ja vazhdoi të funksionoje edhe për një kohë nga lokacione në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Shqipëri, përderisa qindra mijëra njerëz dëboheshin nga Kosova. Nga puna dhe intervistat e KVM-së me refugiatë, ODIHR-i ka publikuar një raport dypjesësh, As seen, As Told (Siç është parë, siç është thënë), i cili ka paraqitur një analizë gjithëpërfshirëse dhe sistematike të të drejtave të njeriut në Kosovë. Pjesa e parë ka shqyrtaur veprimet e të dy palëve në konfliktin e brendshëm të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 1999; pjesa e dytë ka shqyrtaur shkeljet e të drejtave të njeriut në gjysmën e dytë të vitit 1999 pas kthimit të refugiatëve.

Në qershori të vitit u 1999, u krijua një Grup Punues i Përkohshëm për Kosovë, për të ndihmuar planifikimin dhe përgaditjen e një misioni të ri në Kosovë, si dhe për të bashkëpunuar me OKB-në dhe organizatat tjera ndërkombëtarë, në vazhdën e vlerësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë dhe regjistrimit e dokumentimit të lëvizjes së refugiatëve.

## Misioni i OSBE-së në Kosovë

Pas intervenimit të NATO-së në Kosovë në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi rezolutën 1244, e cila bënte thirrje për themelimin e një administratore ndërkombëtare të përkohshme në Kosovë, që do të ishte e pranishme në vend deri në përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Administratës iu dha detyra të ri-themelojë sistemin ligor, administratën civile, ndërtimin e institucioneve demokratike dhe të ndihmojë rindërtimin dhe revitalizimin e ekonomisë në Kosovë.

### OSBE-së

Me 1 korrik të vitit 1999, Këshilli i Përherëshëm i OSBE-së (me vendimin nr. 305) vendosi që të themelojë Misionin e OSBE-së në Kosovë. Detyrat kryesore të saj përfshinin zhvillimin e një force policore të re dhe demokratike, organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, zhvillimin e mediave të përgjegjshme dhe profesionale, zhvillimin e institucioneve funksionale qeveritare në nivelin qendror dhe komunal, zhvillimin e sektorit politik dhe joqeveritar, monitorimin e zhvillimit të gjyqësorit dhe ngritjen profesional të juristëve, promovimin e vlerave demokratike dhe të të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e pozitës së pakicave kombëtare, si dhe grupeve tjera në situata jo të favorshme duke përfshirë gratë dhe të rinjtë.

Praktikisht, për popullatën e Kosovës kjo do të thotë:

- **siguri më e madhe publike;**

OSBE-ja ka themeluar Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës dhe ka trajnuar 7,500 policë të të gjitha gradave për të përkrahur sundimin e ligjit.

- **përfaqësim nga zyrtarë të zgjedhur përmes zgjedhjeve të lira dhe të ndershme;**

OSBE-ja ka organizuar katër palë zgjedhje, dhe ka themeluar dhe trajnuar Komision Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), organ vendor, dhe Sekretariatin e tij që tanë janë pothuajse të gatshëm për të administruar zgjedhjet vetë, duke përfshirë hartimin e një kornize ligjore për zgjedhje.

- **marrje të informatave nga një numër i shtëpive mediale që përpiken të janë profesionale dhe të përgjegjshme;**

OSBE-ja ka themeluar, trajnuar dhe pajisur Radio Televizionin e Kosovës (RTK), transmetuesin publik që tanë gjëzon besimin e publikut dhe përrajen e vazdueshme të OSBE-së. OSBE-ja poashtu ndihmon zhvillimin profesional të mediave lokale. Ajo ka themeluar dhe e mbështet funksionimin e Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm për Media që së shpejti do të bëhet Komisioni i Pavarur i Mediave të Kosovës.

- **shërbim nga administrata publike e cila po bëhet më e kualifikuar dhe më efektive**

OSBE-ja ofron trajnim gjithëpërfshirës për zyrtarët e emëruar dhe të zgjedhur në degën ekzekutive dhe të legjislativit, për të përmirësuar punën e tyre. Për më tepër, ajo koordinon ndihmën ndërkombëtare për Kuvendin e Kosovës, dhe ndihmon në ngritjen e kuadrove të Institutit të Kosovës për Administrim Publik.

- **subjekte politike dhe OJQ më të përgatitura për të përfaqësuar interesat e tyre;**

OSBE-ja ka ndihmuar zhvillimin e partive politike, si dhe themelimin dhe funksionimin e organizatave joqeveritare. Poashtu lehtëson pjesë-marrjen e qytetarëve në punën e autoriteteve qeveritare.

- **sistem të drejtësisë që do t'i mbrojë të drejtat e tyre;**

OSBE-ja monitoron sjelljen e sektorit për zbatim të ligjit dhe atë juridik për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave të njeriut dhe raporton bazuar në këtë mbikëqyrje. Trajnon juristët dhe ka themeluar Institutin Gjyqësor të Kosovës, Qendrën Juridike të Kosovës, Qendrën Burimore për Mbrojtje Penalo-Jurudike si dhe Institucionion e Ombudspersonit. Të gjitha këto institucione janë bërë, ose janë në proces të bërjes, organe të pavarura vendore.

- **jetesë në një shoqëri e cila fillon të implementojë parimet e barazisë dhe**

OSBE-ja punon me institucionet vendore dhe komunikon vullnetin e popullatës për të siguruar se praktikat e tyre janë në pajtim me të drejtat e njeriut dhe marrin në konsiderim nevojat specifike të pakicave dhe grupeve të ndjeshme. OSBE-ja i ndihmon pakicat për të pasur qasje në shërbimet publike, shkollim fillor dhe kujdes shëndetësor, dhe ndihmon në zhvillimin e organizatave të tyre që do të kujdeseshin për nevojat e tyre, duke përfshirë edhe ato informative. Një ndër priorititetet e OSBE-së është edhe ndihma përfshirë joformal dhe rindërtimi, për pjesëmarrje në jetën publike.

- **Që të bëhet i mundur vetëdijësimi i gjeneratave të ardhshme rrëth asaj se çfarë kuptimi dhe ndikimi kanë të drejtat e njeriut dhe demokracia në jetën e tyre.**

OSBE-ja përkrah përfshirjen e mësimit të parimeve të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në shkollimin formal dhe joformal.

Të gjitha aktivitetet e lartpërmendura bëjnë pjesë në dimensionin e rehabilitimit pas konfliktit, por në të njëjtën kohë shpilen edhe drejt parandalimit të konflikteve të ardhshme, e edhe drejt zhvillimit ekonomik. Sidoqoftë, përmesat e ndryshimeve që kërkohen në Kosovë, në krasim me periudhën para vitit 1999, janë jashtëzakonisht të mëdha. Gjashtë vjet të pranisë ndërkombëtare e kanë sjellë Kosovën në fillim të diskutimeve për statusin. Kur statusi të jetë vendosur, Kosova do të mund të ketë nevojë përfshirë ndihmë të mëtutjeshme, në kuptim të përgatitjes së qytetarëve të saj përfshirë revolucionarët e njëjshëm evropiane.

Me gjasë, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) do të jetë njëra ndër agjencionet që do të vazhdojë t'i ofrojë përkrahje popullit të Kosovës.



Përfundimi i konfliktit dhe fillimi i aktiviteteve rehabilituese pas konfliktit kanë sjellur rezultate. Njerëzit kanë qenë në gjendje që të fillojnë të praktikojnë traditën e tyre.

## PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

Shumë gjëra kanë ndryshuar që kur vendet anëtarë të OSBE-së u pajtuan 30 vjet më parë në Helsinki për “të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore”. Megjithatë, u deshën edhe 15 vjet tjera që të hapet ‘Perdja e Hekurt’.

Me themelimin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, 24 vjet pas Helsinkit, u pa qartë se shkelja e të drejtave të njeriut duhej adresuar në mënyrë substanciale. Problemi i parë me të cilin u ballafaqua misioni ishte mungesa e përgjithshme e funksionimit të sistemit gjyqësor, policor dhe atij administrativ. Shumë nga ata individë që së shpejti do të zinin këto pozita është dashur të mësojnë shkatërsi të reja që i kërkonte një shoqëri demokratike.

Meqë insitucionet e sapothemeluara po fillonin të funksionojnë në mënyrë progresive, OSBE-ja tani përballej me rastet gjyqësore, ku shpërfilleshin të drejtat themelore të njeriut, dhe me policinë që shpeshherë duke qenë e hutuar nga gjendja, reagonte në mënyrë të papërshtatshme, duke shkelur të drejtat e njeriut.

Kishte raste kur njerëzit trokisin në derën e OSBE-së duke u ankuar se në banesat e tyre jetonte dikush tjetër, e edhe nga ata që dëshmonin se prona e tyre ishte djegur tërësisht. Komunitetet pakicë të Kosovës informonin misionin se nuk kishin liri të lëvizjes, çka edhe pengonte qasjen e tyre në shërbime publike themelore si shkollat ose objektet shëndetësore. Viktimat e krimit, veçanërisht dhunës në familje ose dh...

Për të adresuar këto të meta, OSBE-ja ka monitoruar sistemin e drejtësisë dhe ka raportuar për të, ka punuar në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve në qeveritë lokale (legjislativ dhe ekzekutiv) në mënyrë që të kuptojnë dhe zbatojnë të drejtat e njeriut, dhe ka trajnuar shërbyesit civilë, gjykatesit, prokurorët, juristët dhe të rinjtë, për të kuptuar dhe zbatuar standardet për të drejta të njeriut. Gjithashtu OSBE-ja ka ndihmuar...

Në fushën e përkrahjes dhe mbrojtjes së viktimate, për shembull, Misioni ka luajtur rol kyç duke hartuar ligje të reja (Rregullore) për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen kundër dhunës në familje, si dhe ka mbështetur zbatimin e tyre. Gjatë procesit të hartimit të ligjeve të reja penale, Misioni ka lobuar me sukses për një rol të institucionalizuar të ‘mbrojtësve të viktimate’ në kodin e ri të procedurës penale, funksioni i të cilëve është ndihma e palëve të démtuara në mbrojtjen e të drejtave të tyre.



*Regjistrimi civil është vendimtar në themelimin e një sistemi permës të cilët njerëzit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre individuale. OSBE-ja ka ndihmuar këtë proces si dhe ka ndihmuar shumë individë, të cilëve u janë shkatërruar dokumentet e identifikimit si përpjekje për t'u mohuar të drejtën për t'u kthyer në Kosovë.*

Së fundi, Misioni i OSBE-së po i kushton vëmendje të shtuar autoritetev vendore, ndryshim ky i domosdoshëm në kontekst të bartjes së kompetencave nga Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) te Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) si dhe përgjegjësive që do të kenë tani e tutje për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Eksperët dhe këshilltarë të misionit u vendosën në zyra të ndryshme qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Misioni parasheh shpërndarjen e këtyre zyrtarëve nëpër tërë rajonin gjatë vitit 2006, për të monituar punën e autoriteteve lokale, pasi që këta të fundit pritet të marrin përgjegjësi të shtuara.

Duke qenë se OSBE-ja ka inicuar dhe përcjellur në mënyrë aktive reformat ligjore e politike, ndryshimet institucionale dhe gjithashu ka ngritur kapacitete të qëndrueshme në mesin e zyrtarëve publikë vendorë nepërmjet monitorimit, raportimit, këshillimit dhe trajnimit, mund të shpresohet se qëllimi jonë për të krijuar dhe lënë prapa një sistem funksional, i cili siguron se do të respektohen të drejtat dhe liritë themelore të të gjithëve, do të arrihet së shpejti.

### Sigurimi i të drejtës për gjykim korrekt – monitorimi i sistemit juridik

Pas konfliktit, UNMIK-u u ballafaqua me një sistem gjyqësor të shkatërruar dhe me detyrën e vështirë të krijimit të një sistemi krejtësisht të ri. Si pjesë e rolit të saj për ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut, Misioni i OSBE-së ka marrë pjesë në këtë proces që nga dita e parë. Misioni ka krijuar Seksionin e Monitorimit të Sistemin Juridik (SMSJ) për të monitoruar sistemin kosovar të drejtësisë, dhe për të vlerësuar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe legjislacionin vendor. Konstatimet e tyre janë shfrytëzuar si bazë për përmirësimin e praktikës së gjykatave.

Misioni ka përcjellë themelimin dhe zhvillimin e sistemit kosovar të drejtësisë që nga koha kur ka rifilluar së funksionuari. Është monitoruar gjykimi i parë që është mbajtur pas luftës në tetor të vitit 1999 - një rast i vrasjes me të cilin është marrë Gjykata e Qarkut në Prizren. “Që nga ai moment e tutje, me zhvillimin e sistemit gjyqësor, zhvillohej edhe puna e Misionit. Çdo vit përqendroheshim në tema të ndryshme dhe kemi nxjerrë vlerësimë lidhur me këto çështje, duke përmendur problemet kryesore dhe duke dhënë rekomandime se si të tejkalojen ato,” thotë Henry McGowen, Drejtor i Departamentit për të Drejta të Njeriut dhe Sundim të Ligjit.

Në fillim të vitit 2000, u identifikuau disa kategori të rasteve të ndieshme si prioritet në fushën e monitorimit. Ato përfshinin rastet e krimeve të luftës, përfshirjen në krimë të motivuara etnikisht, si dhe trafikimin e njerëzëve.

Vlerësimi i parë i Misionit për Sistemin e Drejtësisë Penale u bë publik në tetor të vitit 2000, duke mbuluar pjesën e parë të atij viti. Raporti ka paraqitur fushat kryesore të problemeve, siç janë shkelja e të drejtës në këshillim, mungesa e paanshmërisë në kuadër të gjyqësise dhe problemet lidhur me çështjet e paraburgimit. Që nga ajo kohë janë nxjerrë raporte të rregullta publike, të cilat janë fokusuar në çështje të ndryshme me ndikim në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë, siç është paraburgimi i paligjshëm, kërcënimi i dëshmitarëve, cilësia

e dënimive dhe administrimi i drejtësisë në gjykata komunale. Të gjitha këto çështje janë trajtuar në përputhje me standardet që dalin nga marrëveshjet ndërkombe të përdorur për të drejta të njeriut e që lidhen me përbajtjen e së drejtës në gjykim korrekt dhe të drejtët e lirisë personale.

Pas pesë vitesh të monitorimit të rasteve penale, në shtator të vitit 2004 u nënshkrua një marrëveshje në mes të Departamentit të Drejtësisë, në kuadër të UNMIK-ut, dhe Misionit të OSBE-së, e cila u lejonte monitoruesve të OSBE-së qasje në të gjitha procedurat gjyqësore në gjykatat civile dhe administrative. Në bazë të kësaj marrëveshje, në janar të vitit 2005, SMSJ-ja filloi të monitorojet lëndët civile dhe penale. Në mesin e padive civile u identifikuan një numër fushash prioritare, siç janë kontestet pronësore në mes të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, rastet nga e drejta familjare dhe e drejta e punës, si dhe procedurat ekzekutive. Monitorimi i këtyre fushave do të finalizohet me një vlerësim vjetor, i cili do të prekë problemet kryesore dhe do të ketë ndikim në trajtimin e atyre rasteve nga gjykatat kosovare në të ardhmen.

“Pa ndërhyrje në procedurat gjyqësore, Misioni i OSBE-së ndjek një strategji të monitorimit proaktiv dhe ka funksion korrekture brenda sistemit të drejtësisë,” shtoi z. McGowen. Zbatimi i rekomandimeve konkrete të cekura në raporte pasohet me takime mes Misionit dhe përfaqësuesve të gjyqësorit, si dhe homologëve të UNMIK-ut.

Duke bashkëpunuar ngushtë, Misioni dhe Instituti Gjyqësor i Kosovës bëjnë të mundur që boshillëhet e konstatuara gjatë monitorimit të plotësohen përmes trajnit të gjykatësëve dhe prokurorëve në fushat që kanë nevojë për përmirësim.

Përderisa Misioni pranon se që nga rithemelimi i sistemit të drejtësisë në Kosovë në vitin 1999 e deri më sot është arritur mjaft, mbetet ende shumë punë për t'u bërë. Së shpejti, një numër i konsiderueshëm i kompetencave brenda administratës së drejtësisë do t'u transferohet autoriteteve vendore. Misioni do të monitorojë këtë proces dhe do të vazhdojë të sigurojë se administrata e drejtësisë në Kosovë është në pajtim të plotë me standardet e aplikueshme ndërkombe të të drejtave të njeriut.



*Pas monitorimit të sistemit gjyqësor, Misioni i OSBE-së publikon rekomandime dhe e këshillon gjyqësorin se si të përmirësojë funksionimin e tij dhe të ofrojë mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut.*

## **Ekspertët e të drejtave të njeriut në kuadër të policisë**

Në vitin 1999 UNMIK-u solli një forcë policore ndërkombe (policia e UNMIK-ut) në Kosovë dhe paralelisht nisi ngritjen e Shërbimit të ri Policor të Kosovës (SHPK). Misioni i OSBE-së, në anën tjetër, filloj trajimin e forcave të reja policore në Shkollën e SHPK-së (apo Departamentin e OSBE-së për Edukim dhe Zhvillim të Policisë), duke përcjellë për së afërmë zhvillimet që kishin të bëjnë me policinë dhe të drejtat e njeriut.

Që nga fillimi, Misioni ka monitoruar agjencionet për zbatim të ligjit dhe është marrë me raste individuale nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Më vonë, kjo nismë mori një qasje më tematike, duke hartuar raporte mbi çështje të caktuara të të drejtave të njeriut, dhe duke ia paraqitur ato autoriteteteve të policisë për të tërhequr vëmendjen e tyre për çështjet e lartpërmendura.

Në vitin 2005, me qëllim të krijimit dhe kultivimit të një kulture të të drejtave të njeriut në kuadër të policisë, Misioni ka inicuar zbatimin e programit të Ekspertëve për të Drejta të Njeriut (EDNj), pas marrëveshjes së arritur me udhëheqjen e Policisë së UNMIK-ut rreth përshkrimit të detyrave të EDNj-ve.

Ekipet e Ekspertëve të të Drejtave të Njeriut vendosën pranë shtabit kryesor të policisë në Prishtinë dhe gjashë zyrave rajonale. Ata këshillojnë SHPK-në dhe Policinë e UNMIK-ut se si të zhvillojnë politika dhe veprime që janë në pajtim me të drejtat e njeriut. Njëkohësisht, ata punojnë në ngritjen e kapaciteteve të policisë, në mënyrë që ata t'i kryejnë detyrat sipas parimeve të të drejtave të njeriut. D. Christopher Decker, këshilltar i lartë i të drejtave të njeriut për çështje të sigurisë, tha se kjo qasje bën të mundur që Misioni të ndikojë në vendimet që merr policia në një fazë të hershme, dhe që në kontekst afatgjatë këto ndryshime të jenë të qëndrueshme.

“Ekspertët punojnë ngushtë me oficerët e lartë dhe ata më të rinj. Me qëllim të bashkëpunimit më të mirë, zyrat e ekspertëve gjinden pranë zyrave të komandantëve të policisë dhe puna bëhet nga objektet e policisë,” shtoi ai.

EDNj-ja përqëndron aktivitetet e veta në fusha siç janë: arrestimet dhe paraburgimet; të drejtat e të arrestuarve që u takojnë grupeve si:

të miturit, të sëmurët mentalë dhe ata që kanë nevojë për trajtim mjekësore; të drejtat e viktimate, sidomos viktimat e dhunës në familje dhe dëshmorët e trafikimit; transparensa dhe besimi i opinionit publik në polici, duke përfshirë ankesat e brendshme dhe mbikëqyrjen. Ata, gjithashtu, identifikojnë nevojat për ngritje të kapaciteteve dhe ndihmojnë policinë në organizimin e trajnimeve.

Zbatimi i suksesshëm i programit varet shumë nga besimi i ndërsjellë në mes të policisë dhe EDNj-ve. Kjo, gjithashtu, varet nga përkushtimi i të gjitha palëve të përfshira që mbrojten e të drejtave të njeriut ta marrin si bazë dhe arsyë në punën e tyre.



*Forca policore luan rol të madh në sigurimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Andaj, edukimi i tyre dëshmorët e praktikave të të drejtave të njeriut janë ndër prioritetet e Misionit të OSBE-së.*

## PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT

### Përforcimi i së drejtës pronësore në Kosovë

Respektimi i së drejtës pronësore varet shumë nga fakti se sa publiku i përbahet ligjit dhe se sa efikase janë autoritetet në zbatimin e legjislacionit mbi pronën.

Në Kosovë, mbrojtja e së drejtës pronësore është në një shkallë tepër të ulët. Shkaktari kryesor për një pozitë të tillë qëndron në traditën dhe shpërdorimet e një sistemi që bazohej në pronën shoqërore, një dekadë të tërë diskriminimi të shqiptarëve të Kosovës nga regjimi i mëparshëm, konflikti i armatosur dhe marrja e dokumentacionit arkivor, si dhe shkatërrimi i pronës së grupeve pakicë dhe shumicë pas luftës.

Përveç kësaj, përpjekjet e dobëta për reformim të legjislacionit dhe krijim të mekanizmave të pamjaftueshëm ad hoc për të zgjidhur kontestet pronësore, si dhe atmosfera e përgjithshme e jostabilitetit dhe parregullsitë, kanë bërë që mbrojtja e së drejtës pronësore të jetë një nga priorititet kryesore të OSBE-së.



E drejta pronësore është një ndër të drejtat themelore të njeriut. Në të shumtën e rasteve, ndërtimet pa leje ose usurpimet e pronës së huaj vështirësojnë mundësinë e dikuq për të ushqruar të drejtën pronësore të tij/saj.

Për të pëershkruar përmasat e problemit mjafton që të përmenden vetëm disa shifra. Përveç mijëra rasteve tjera, afro 20,000 anesa që ndërlidhen me konteste pronësore mbisin të pazgjdhura në gjykatat e regulit. Për më tepër, vlerësohet se rreth 11 mijë anesa të mundshme për pronën bujqësore dhe komerciale nuk janë parashtruar ende. Drejtoreti për Çështje Pronësore-Banesore, përgjegjës për anesa që kanë të bëjnë me kontestet pronësore-banesore, deri më tanë ka zbatuar vetëm 52.3 për qind (15,864) nga 28,431 vendime. 6,950 nga vendimet e zbatuara lidhen me pronën e shkatërruar.

“Për të adresuar këto çështje, OSBE-ja punon ngushtë me institucionet në nivel qendror e lokal, si dhe ofron këshilla se si të zgjidhen rastet ekzistuese dhe si të parandalohen shkeljet e së drejtës pronësore në të ardhmen,” tha Jose Maria Arraiza, Këshilltar i Lartë për Çështje Pronësore. Misioni gjithashtu këshillon qeverinë për çështje që ndërlidhen me të drejtën, siç janë procesi i rregullt gjyqësor, e drejta për zgjidhje efikase, dhe e drejta për kthim të të gjithë personave të zhvendosur.

Mirëpo ofrimi i këshillave nuk është i mjaftueshëm. Organet e qeverisë duhet të zhvillojnë kapacitetet e veta për t'u marrë me këto çështje. Misioni ndihmon edhe në këtë aspekt, duke ofruar trajnime dhe duke ndihmuar në hartimin e ligjeve dhe vetëdijësimin publik rreth efekteve negative të usurpimit të paligjshëm.

OSBE-ja, gjithashtu, mbështet zhvillimin e planit të punës për reformën ligjore, që ka të bëjë me pronën, bazuar në modelet rajonale të suksesshme të është Sllovenia.

Përveç kësaj, Misioni ka ndihmuar IPVQ-të dhe UNMIK-un në përmirësimin e sistemit, duke nxjerrë raporte që rekomandojnë zbatim të masave me qëllime konkrete, si p.sh. shtjellimi dhe zbatimi i plotë i reformës ligjore që lidhet me pronën dhe me planin e punës, themelimi i mekanizmave efikas për zgjidhje të kontesteve pronësore, zbatimi nga ana e autoriteteteve komunale i procedurave ligjore që kanë të bëjnë me shpronësimin, ndërtimin dhe planifikimin hapësinor, integrimi i strukturave paralele administrative dhe rregullimi i hapësirave banuese të vendbanimeve joformale.

Misioni, gjithashtu, në mënyrë proaktive ka koordinuar ‘Planin për Implementim të Standardeve’ që lidhet me pronën: një master plan strategjik për reformim të mekanizmave të së drejtës pronësore dhe sigurimi i mbrojtjes së të drejtave, veçanërisht nga ana e autoriteteteve lokale.

Për më tepër, OSBE-ja përqendrohet në mbrojtjen e atyre që janë më të prekur nga sistemi jo-funksional i së drejtës pronësore. Për shembull, një aspekt ka qenë që të sigurohet mbrojtja e të drejtave të atyre që me dekada jetojnë në vendbanime joformale. Misioni mbron të drejtën e banimit për të gjithë, dhe për këtë arsy do të vazhdojë që në mënyrë proaktive të monitorojë situatën dhe ndihmojë institucionet – komunat, ministritë, gjykatat dhe policinë – që të zhvillojnë mjete efektive për të menaxhuar çështjet pronësore, në pajtim me standartet ndërkombëtare.

### Grugë e gjatë deri te zbatimi i ligjit kundër diskriminimit

Duke marrë parasysh faktin se praktikat diskriminuese të qeverisë ndaj një pakice të perceptuar,(ë) sollën deri te konflikti i fundit më përmasa shkatërruese në Kosovë, OSBE-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit të përsëritjes së kushteve për një konflikt të tillë.

Misioni ka inicuar hartimin e Ligjit Kundër Diskriminimit (LKD) në vitin 2002, pas një viti konsultimesh me palë të shumta të interesit. Janë dashur edhe dy vite të tjera punë që ligji të hyjë në fuqi, dhe tashmë Kosova i ka ligjet më progresive dhe fleksibile të llojut të vet në Evropën Qendrore dhe Lindore.

Që nga miratimi dhe shpallja e këtij ligji, një numër i madh akterësh nga qeveria dhe donatorë ndërkombëtarë, duke përfshirë OSBE-në si bashkëbisedues kryesor, kanë punuar së bashku në hartimin e një Plani Gjithëpërfshirës për Zbatim, me qëllim që parimi kryesor i ligjit – apo “trajtimi i barabartë” – të futet në çdo aspekt të jetës shoqërore.

Përderisa në disa vende janë vetëm personat me autoritet që i neshyrohen ligjeve për të drejta të njeriut, LKD-ja është më progresive ngase kërkon trajtim të barabartë edhe në mesin e personave privatë. Për më tepër, ligji bart barrën e sigurimit të dëshmive nga paditësi tek i padituri. Edhe pse forma të ndryshme të diskriminimit ndodhin në çdo shoqëri, definimi i trajtimit të barabartë në këtë ligj është fleksibil ngase mëton t'u qaset formave unike të diskriminimit që dihet se ndodhin në Kosovë. Definimi i trajtimit të barabartë në LKD bën dallimin në mes:

## Përkatësisë etnike, kombit dhe racës

Para së gjithash, LKD-ja zëvendëson dallimet ligjore të ish-Jugosllavisë në mes të personave konstitutivë, kombit dhe grupeve etnike. Në LKD, përkatësia etnike ka domethënë si kombinim i pavarur i origjinës, gjuhës, besimit, zakoneve, etj. Për shembull, një fëmije që i ndalohet qasja në shkollim fillor për shkak se ai/ajo i përket një grupi tjetër etnik dhe vishet me rroba tradicionale tjera, shokët e tij/saj, do të bënin diskriminim në bazë të përkatësisë etnike.

Kombi i referohet lidhjes me një shtet të caktuar, veçanërisht nëpërmjet shtetësisë në atë shtet. Në këtë mënyrë, personat me përkatësi të ndryshme etnike mund t'i takojnë të njëjtët komb, andaj sipas LKD-së, duhet të gëzojnë të drejtën e njëjtë të trajtim të barabartë nga qeveria e tyre. Raca ka të bëjë me tiparet gjenetike që janë përdorur historikisht për të dalluar grupet sipas pamjes së jashtme, siç është ngjyra, megjithëse nuk ka bazë shkencore për parashikimin e potentialit njerëzor. Nëse familjet me ngjyrë të lëkurës më të zezë aplikojnë për të marrrë me qira apartament në Kosovë dhe nuk pranohen për shkak të pamjes së jashtme, kjo do të ishte diskriminim racor.

## Gjinisë dhe rolit gjinor

Përderisa gjinia përcaktohet nga dallimet biologjike të meshkujve dhe femrave, roli gjinor ka të bëjë me ndërtimet kulturore të rolit gjinor, privilegjet dhe përashtimet. Për shembull, refuzimi i punësimit të një femre si shërbyese në restorant ngase normat shoqërore diktojnë se shërbimi i ushqimit dhe pijeve në vende publike është profesion “i meshkujve” do të paraqiste diskriminim në bazë gjinore.

Për t'i paraqitur këto parime të trajtimit të barabartë në kulturën kosovare, drafti më i fundit i Planit dyvjeçar Gjithpërfshirës për Zbatim të LKD-së ka mbledhur në një vend ekspertizën nga çdo sektor i qeverisë, gjyqësori, Institut i Ombudpersonit dhe shoqëria civile.

**“Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurfarëdiskriminimi të drejtëpërdrejt apo të tërthortë ndaj personit, në bazë të gjinisë, moshës, gjendjes martesore, gjuhës, paaftësise fizike apo mendore, orientimit seksual, kombit, mendimit apo bindjes politike, religjonit apo besimit, përkatësisë etnike apo sociale, races, pronës, lindjes ose statuseve tjera.”**


Neni 2 (a) i Ligjit Kundër Diskriminimit



*Grupet sociale të ndjeshme - gratë dhe fëmijët - janë shpesh viktimë e formave të ndryshme të diskriminimit. Strehimi i tyre nganjëherë është zgjidhja e vetme. Misioni i OSBE-së përkrah punën e një numri të strehimoreve.*

Misioni i OSBE-së do të mbetet pjesëmarrës i përkushtuar gjatë zbatimit të planit në terësi. Ai ofron mbështetje strategjike dhe resurse njerëzore, përfshirë asistencë të teknike vazhdueshme dhe të gjërë, si dhe trajnim të zyrtarëve të qeverisë ashtu që si shkëmbim këta të fundit t'i kontribuojnë koordinimit të parimeve kundër diskriminimit në hartimin e akteve nënligjore, si dhe politikës dhe praktikave në fushat e tyre përkatëse.

Për shembull, “veprimi pozitiv” përfshirë këtu masat “për parandalimin ose kompensimin për dëmtimet që lidhen me një apo më shumë raste si ato të cekura në nenin 2 (a)” mund të janë të domosdoshme në sektore të veçanta, siç janë shëndetësia, arsimi, transporti, planifikimi hapësinor, etj. Për më tepër, plani propozon një fushatë afatgjatë të informimit publik (për të cilin misioni tashmë ka filluar të financojë përgatitjen e posterëve dhe broshurave) si dhe plotësimë në planprogramin e shkollave publike.



*Për shkak të diskriminimit etnik, e drejta e shkollimit themelor i'u mohohet shumë fëmijëve kosovar.*

## PËRKRAHJA PËR SUNDIMIN E LIGJIT

Sundimi i ligjit është parakusht themelor për zhvillim politik, social dhe ekonomik. Sistemi ligjor i bazuar në parimin e sundimit të ligjit është i besueshëm dhe i qëndrueshëm. Besueshmëria dhe qëndrueshmëria janë të domosdoshme për krijimin e një sistemi ekonomik ku prona është e mbrojtur dhe investimet janë të sigura. Për më tepër, sundimi i ligjit e bën shoqërinë akoma më stabile dhe të sigurt, pasi që kriminaliteti ndiqet penalisht dhe të drejtat e njeriut respektohen.

Gjatë gjashtë viteve të fundit, Misioni i OSBE-së ka qenë përgjegjës për të ndihmuar vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë, duke zhvilluar sistemin a saj ligjor. Hapat e parë të marrë në vitin 1999 kanë përfshirë ofrimin e ndihmës deri në rivendosjen e sistemit ligjor duke i identifikuar gjyqtarët, si dhe ofrimin e përkrahjes së nevojshme teknike dhe logjistike gjatë themelimit të gjykatave.

Në vitin 1999, edhe Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) ka qenë në gjendje jo të rregullt. OAK-së i kanë munguar strukturat fizike, kurse Asambleja e Përgjithshme e OAK-së nuk është mbledhur nga viti 1992 deri në vitin 2000. Në fillim, Misioni ka përkrahur OAK-në duke e bërë një vlerësim të detajuar të komunitetit ligjor në Kosovë dhe duke ndihmuar mbledhjen e e Asamblesë së Përgjithshme të OAK-së në vitin 2000. Që atëherë, Misioni ka vazhduar t'i ofrojë ndihmë AOK-së përmes programeve edukative, ngritjes së kuadrove dhe përkrahjes teknike.



*Sundimi i ligjit është garancë kryesore për mirëqenien e njerëzve. Shpërthimi i dhunës dhe veprimet tjera të paligjshme e dëmtojnë tërë shoqërinë. Trazirat e dhunshme të marsit të vitit 2004 janë shembulli më i mirë. Ato kanë rezultuar me vdekjen e një numri të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.*

Gjatë gjashtë viteve të fundit, OSBE-ja ka punuar edhe në zhvillimin e institucioneve të pavarura të cilat promovojnë sundimin e ligjit. Këto institucionë përfshijnë Institucionin e Ombudspersonit, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Qendrën Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike dhe Qendrën Juridike të Kosovës.

Aktualisht, Misioni vazhdon të implementojë mandatin e vet – të promovojë zhvillimin e institucioneve të cilat sigurojnë se parimet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit respektohen. Misioni vazhdon të implementojë projekte për ngritjen e kuadrove të dizajnuara për të fuqizuar profesionistët ligjor dhe institucionet profesionale, të cilat iu mundësojnë atyre t'i shërbejnë komunitetit më mirë. Këto përfshijnë: përkrahjen e OAK-së përmes projekteve si arsimimi ligjor i vazhdueshëm; përkrahjen e punës së OJQ-ve të cilat mirren me ofrimin e shërbimeve ligjore; si dhe ndihmën për mbajtjen e provimit të jurisprudencës.

Për më tepër, Misioni vazhdon të monitorojë, analizojë dhe hartojë raporte për gjendjen e sundimit të ligjit në Kosovë, derisa zhvillon strategji konkrete dhe rekomandime për të adresuar problemet. Fushat në të cilat Misioni është përqëndruar kohëve të fundit përfshijnë zgjidhjen aleternative të kontesteve gjyqësore, ndihmën ligjore dhe zbatimin e ligeve të Kuvendit të Kosovës. OSBE-ja po ashtu ofron përkrahje teknike ligjore për IPVQ-të, duke shqyrtau draft legjisacionin sa i përket qartësisë legislative dhe parimeve të sundimit të ligjit.

### Zbatimi i Ligjeve të Kuvendit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës aprovon ligje por zbato hemi dhe aplikimi i tyre shpesh bëhet me vonesë. Arsyja kryesore është mungesa e akteve nënligjore.

Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) janë relativisht të reja dhe ekziston shqetësim se Qeveria dhe ministritë jo gjithmonë i zbatojnë apo aplikojnë ligjet e Kuvendit si duhet. Kjo mund të çojë në sistem joefikas të ligjeve dhe mungesë të besimit publik në IPVQ.

Për të vlerësuar se deri në çfarë mase zbatohen në praktikë ligjet e aprovarura nga Kuvendi, Misioni i OSBE-së, kohëve të fundit, ka monitoruar zbatimin e 24 ligjeve të shpallura në vitin 2003.

Faza e parë e e humlumtimit është përqendruar në përcaktimin se cilat akte nënligjore duhet të përpilohe në përfundim të zbatuar ligjet, kush është përgjegjës për miratimin e këtyre akteve, dhe cilat njësi të organizatave duhet të themelohen për të pasur institucionale funksionale. "Një matriks (formë) me dispozitat e rendësishme nga të 24 ligjet është përgatitur dhe përdorur në vazhdimësi gjatë humlumtimit," tha Henry McGowen, Drejtor i Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit në OSBE.



*Derisa Kuvendi i Kosovës miraton ligje, zbatimi i tyre ngec për shkak të mungesës së legjisacionit nën-ligjor. OSBE-ja ndihmon degën legislative dhe atë ekzekutive në përpjekjet e tyre për të zgjidhur këtë çështje.*

Intervistat të cilat janë zhvilluar gjatë fazës së dytë kanë përfshirë zyrtarë nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjeve. Matriksi ka shërbyer si një mjet për të verifikuar cilat dispozita të ligjit janë zbatuar nga cilat akte nënligjore.

Vlerësimi i përgjithshëm i raportit të parë, i publikuar në shkurt të vitit 2005, ka qenë se zbatimi i ligjeve të Kuvendit të Kosovës ka filluar me një vonesë të caktuar, pas të cilës shumica e institucioneve përgjegjëse kanë arritur t'i tejkalojnë gradualisht vështirësitë fillestare. "Aktualisht, ato kanë arritur sukses të konsiderueshem në procesin e implementimit," shton McGowen.

Hulumtimi, po ashtu, ka identifikuar mungesë të resurseve të mjaftueshme në zyrat ligjore të ministrive, si dhe përqendrimin në përpilimin e legjislativit të ri në vend të implementimit të ligjeve të

cilat veç janë në fuqi si dy arsyet kryesore për vonesën e zbatimit të ligjeve.

Rekomandimi kryesor i raportit të parë ka qenë të shtohet përgjegjësia e ekzekutivit të IPVQ-ve në aprovimin e legjislativit nënligjor. Kjo duhet të arrihet përmes themelimit të një mekanizmi mbikëqyrës për zbatimin e ligjeve brenda zyres së Kryeministrat dhe me një mbikëqyrje parlamentare periodike të shtuar për aktivitetet e ekzekutivit.

*Një raport përcjellës për vlerësimin e zbatimit të ligjeve të miratuar në vitin 2004 është duke u hartuar aktualisht dhe do të publikohet këtë vit. Gjersa përsërit rekomandimet e më hershme, theksin edhe progresin e bërë në hartimin e legjislativit ndihmës. Raporti gjithashtu thekson se vonesat në hatrmin e legjislativit ndihmës po e pengojnë zbatimin e ligjeve ekzistuese.*



Marek Antoni Nowicki ka qenë Ombudsperoni i parë i Kosovës. Ai ua ka kaluar përgjegjësitet e veta kolegëve të tij vendor në fillim të vitit 2006.

## Institucioni i Ombudspersonit

Si pjesë e mandatit të saj për të ndërtuar dhe përkrahur institucionet vendore në Kosovë, Misioni i OSBE-së ka ndihmuar themelimin e Institucionit të parë të Ombudspersonit (IO) në Kosovë. I themeluar me 21 nëntor të vitit 2000, si organ shumëetnik, ky institucion ka filluar të funksioniojë si i pavarur në maj të vitit 2001.

"Institucioni i Ombudsperonit është mbrojtësi kryesor i të drejtave të njerëzve në shumë shoqëri të Evropës Perëndimore," tha Henry McGowen, Drejtor i Departamentit të të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjt të OSBE-së.

Misioni i OSBE-së në Kosovë, fillimisht ka përkrahur IO-në përmes Seksionit të saj për Përkrahjen e Ombudsperonit, i cili ka ndihmuar në përpilimin e rregullave të punës së IO-së dhe në ofrimin e trajnimeve mbi të drejtat e njeriut për stafin e Institucionit. Misioni, po ashtu, ka organizuar fushata për informim publik për të ngritisur vetëdijen për rolin e Ombudsperonit.

Detyra më me rëndësi e IO-së është shqyrtimi i ankesave të bëra nga çdo person apo entitet në Kosovë që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe veprimet që përbëjnë keqpërdorim të pozitës nga administrata e përkohshme civile si dhe nga institucionet qendrore apo lokale.

Institucioni i Ombudsperonit në Kosovë pranon ankesat në lidhje me shpërdorimet e supozuara nga autoritetet. "Institucioni punon në atmosferë të transparencës, duke ruajtur konfidencialitetin kur është e domosdoshme të mbrohen ankuesit, dëshmitarët ose personat e tjera të përfshirë në raste," shtoi McGowen.

Gjatë ose pas hetimeve, Ombudsperoni mund t'u bëjë rekomandime autoriteteve relevante administrative dhe zyrtarëve, për masat që duhet të mirren, duke përfshirë edhe masa të përkohshme nëse është e nevojshme. "Nëse autoritetet e adresuara nuk marrin masat e këruara, apo nuk ofrojnë arsyë të pranueshme për mosrespektimin e rekomandimeve, Ombudsperoni mund të tërheq vëmendjen e PSPS-së për këtë çështje dhe mund të bëjë deklaratë publike," përfundoi McGowen. Për të qenë në gjendje të bëjë hetime të mirëfillta, Ombudsperoni duhet të ketë qasje të plotë në dosje dhe dokumente dhe zyra të IPVQ-së dhe administratës së përkohshme civile.

Aktualisht, Institucioni i Ombudsperonit është paraparë të bëhet têrësisht institucion vendor me 1 janar të vitit 2006. OSBE-ja punon me organizatat dhe institucionet tjera për të siguruar mbarëvajtjen e procesit të transferimit. Misioni do të vazhdojë të përkrahë punën e IO-së në vitin 2006 përmes këshilltarëve.

## PËRKRAHJA PËR SUNDIMIN E LIGJIT

### Instituti Gjyqësor i Kosovës

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka lindur nga roli i misionit të OSBE-së për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë ditëve të para të saj. Në gusht të vitit 1999, Misioni ka themeluar Seksionin për Trajinim Juridik i cili është zhvilluar gradualisht, dhe në shkurt të vitit 2000 është bërë Instituti Gjyqësor i Kosovës. Vizioni i Institutit është të bëhet shkollë e mirëfilltë për juristë brenda strukturës së përgjithshme qeveritare të Kosovës.

Mandati i IGJK-së është të trajnojë gjykatës dhe prokurorë për të shtuar kompetencën e tyre profesionale dhe teknike. Kohëve të fundit, instituti është duke implementuar dy programe kryesore trajnimi: Programin për Arsim Ligjor të Vazhdueshëm (PALV) dhe Programin Fillestar për Arsim Ligjor (PFAL).

“PALV-ja përfshin aktivitete trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë brenda dhe jashtë Kosovës,” tha Katya Dormisheva, bashkëdrejtoreshë ndërkombëtare e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Sipas strategjisë më të re trajnuese, IGJK-ja organizon seminare dhe tryesa të rrumbullakëta të rregullta në të gjitha rajonet e Kosovës, si dhe vizita studimore në vende tjera.



Programi për Arsim Ligjor të Vazhdueshëm ka për qëllim rriten e kapaciteteve profesionale dhe teknike të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në fillim të vitit 2005, Këshilli Juridik dhe Prokurorial i Kosovës (KJPK) i ka dhënë mandatin IGJK-së të organizojë Programin e parë Fillestar për Arsim Ligjor (PFAL) si një modul pilot tre mënyrës paraemëres për kandidatët juridik. Shumë profesionistë ligjorë të dalluar të të gjitha niveleve të gjyqësisë dhe prokurorisë në Kosovë, kanë qenë të përfshirë si trajnues në PFAL.

“Pas përfundimit të kursit, 57 nga 60 kandidatët e zgjedhur fillimisht kanë qenë të sukseshëm në ndjekjen dhe përfundimin e PFAL-it,” tha Dormisheva.

Aktualisht, IGJK-ja është ende pjesë e Misionit të OSBE-së, por në pajtim me Planin për Implementimin e Standardeve, një draft-ligj, i cili e bën IGJK-në institucion të pavarur, është gati për t'u aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

“Duke pritur pavarësinë e plotë institucionale, IGJK-ja është duke synuar standartet më të larta të profesionalizmit në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ka për qëllim të jetë një ndër institucionet e reja më të efektshme dhe vetëqëndrueshme të Kosovës,” përfundoi Dormisheva.


### Qendra Juridike e Kosovës

Një ndër pyjet e para të cilën bashkësia ndërkombëtare ia shtroi administratës së përkohshme të OKB-së, ishte si do të zhvilloni një shoqëri demokratike, bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Një nga përgjigjet ishte se: “kjo mund të arrihet duke përmirësuar shkathësitë e profesionistëve ligjorë vendorë”.

Në qershorr të vitit 2000, Misioni i OSBE-së themeloi Qendrën Juridike të Kosovës (QJK) me vizion për të zhvilluar një OJQ profesioniste dhe të pavarur e cila do të promovojë parimet demokratike, shumëlojshmërinë e kulturave, standartet etnike, sundimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. QJK-ja tanë implementon një varg programesh - që nga hulumtimi ligjor dhe analizat deri te programet që ndihomjnë për të kuptuar ligjin dhe proceset ligjore më mirë.

“Në fillim, ne kemi përkrahur funksionimin e QJK-së duke e ndihmuar atë sa i përket stafit dhe trajnimit të tyre, por kemi ofruar edhe përkrahje logjistike,” tha Henry McGowen, Drejtor i Departamentit të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit të OSBE-së. Duke ngritur



Qendra Juridike e Kosovës organizon hulumtime ligjore dhe ndihmon që opinioni publik të kuptojë më mirë ligjin dhe proceset ligjore.

kapacitetet e tyre, ne i'u kemi kaluar atyre shumë e më shumë përgjegjësi dhe prej këtij viti ata funksionojnë si OJQ kosovare e pavarur," shtoi McGowen.

QJK-ja zhvillon hulumtime dhe analiza, duke publikuar materiale siç është gazeta 'Studimet Juridike të Kosovës', Buletini i Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, dhe Përpilimi i Ligjeve të Aplikueshme. Kjo e fundit është e një rëndësie të madhe pasi që ekziston problem i përgjithshëm për qasje në legjislacion. QJK-ja po ashtu përkthen, publikon dhe shpërndan përzgjedhje të rëndësishme të ligjeve të aplikueshme.

Për të adresuar grupe të ndryshme të cilat janë cak i QJK-së, kjo qendër ka hartuar projekte specifike. Një shembull i kësaj ka qenë programi "E Drejtë për të gjithë" i cili ka ngritur vetëdijen për sundimin e ligit dhe demokracinë me grupet më të lëndueshme të shoqërisë, siç janë: gratë, minoritetet, të miturit dhe të burgosurit. Në anën tjetër, programi për arsimim ligjor të vazhdueshëm për juristë, ka pasur për qëllim të azhurnojë rregullistikët e Kosovës për çështje ligjore të përzgjedhura. Së fundi, QJK-ja po ashtu implementon një program të ngjashëm për nëpunësit civilë në të gjitha komunat e Kosovës.

Aktualisht Misioni e përkrah QJK-në duke financuar publikimin e materialeve specifike ligjore dhe përpilimet e ligjeve të aplikueshme.



Avokatët mbrojtës nga mbarë Kosova përcjellin dhe përfitojnë nga aktivitetet e QBMPJ-së.

## Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike

Për të arritur "barazi të palëve në procedurë" për avokatët mbrojtës të cilët punojnë pranë gjykatësve dhe prokurorëve, Misioni i OSBE-së në Kosovë në vitin 2001 ka krijuar Qendrën Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike (QBMP). Qendra është pavarësuar nga përkrahja e OSBE-së dhe është regjistruar si OJQ që punon në të mirë të publikut në janar të vitit 2004. Tani ajo ndihmon avokatët mbrojtës të Kosovës gjatë përfaqësimit të personave të akuzuar për shkelje të ligjeve penale dhe punon për të siguruar se të drejtat e të akuzuarve mbrohen gjatë gjithë procesit ligjor.

QBMP-ja vepron si qendër burimore për avokatët mbrojtës dhe përqendrohet në dhënien e drejtëpërdrejtë të ndihmës në rastet gjatë të cilave avokatët mbrojtës përfaqësojnë personat nën hetime ose të akuzuar për kundërvajtje nën ligjin e së drejtës ndërkombëtare dhe krimet tjera të rënda të motivuara etnikisht ose politikisht.

QBMP-ja lufton për mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve në të gjitha fazat e procesit ligjor. QBMP-ja po ashtu përqendrohet në rastet tjera që kanë të bëjnë me shkeljet e rënda dhe sistematike të standardeve ndërkombëtare gjatë hetimeve, ndjekjes penale dhe/ose procesit gjyqësor. Këto raste mund të përfshijnë mbajtjen e paligjshme apo arbitrage në paraburgim, gjykim ose ndjekje penale të njëanshme ose korrucion, ndërrhyre të palës së tretë në pavarësi të gjyqësorit, dhe zbatim jo i mirë i drejtësisë.

Përveç kësaj, QBMP-ja poashtu ndërmerr hulumtime ligjore për çështje të përgjithshme të ligjit penal dhe çështje të përgjithshme që janë të rëndësishme për avokatët mbrojtës. Rezultatet e këtij hulumtimi pastaj aplikohen në raste individuale dhe/ose formojnë bazën e moduleve të trajnimeve për këto çështje. Për më tepër, rezultatet e këtyre hulumtimeve i'u shpërndahen avokatëve mbrojtës vendorë, të cilëve edhe i'u dedikohen kryesisht, dhe po ashtu vihen në dispozicion të partnerëve të cilët i'u shërbejnë anëtarëve të tjerë të komunitetit ligjor të Kosovës (gjyqtareve, prokurorëve dhe profesorëve të Juridikut).

Në fund, QBMP-ja, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës, ka ndihmuar në ofrimin e trajnimeve dhe seminareve për arsim ligjor për avokatët mbrojtës. Programet kryesore të trajnimit janë orientuar në rritjen e shkathtësive dhe përqendrohen në aspektet praktike siç janë përgatitja e lëndës dhe strategjitet, hulumtimi ligjor dhe shkathtësitet interpretuese, si dhe strukturimi dhe prezantimi i argumenteve përmes prezantimit me gojë ose me shkrim.



Qendra Burimore për Mbrojtje Penalo-Juridike (QBMPJ) ofron trajnime dhe seminare për edukim ligjor të avokatëve mbrojtës.

## PËRKRAHJA E SHOQËRISË CIVILE

vëzhgojnë punën e organeve qeveritare dhe të ndërhyjnë sipas nevojës, ashtu që interesat e qytetarëve të rëndomtë apo grupeve specifike shoqërore të promovohen dhe të respektohen.

Në vitet 1999-2003, paralelisht me ndihmën në themelimin e Institucioneve të Përkohshme Vëtëqeverisëse, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ndihmuar edhe OJQ të reja dhe nisma qytetare, si dhe ka përkrahur ato që tashmë janë aktive. Gjatë dy viteve të fundit, kjo ndihmë ka kaluar në inkurajim dhe këshillim të subjekteve qytetare ekzistuese, që kanë pasur potencial dhe gatishmëri të marrin pjesë aktive në jetën shoqërore të Kosovës.

“Aktivitetet tona qendore janë të drejtuara drejt ngritjes së aftësive të pjesëmarrësve qytetarë për të ndikuar në politikën publike dhe vendimarrje në të dy nivelet qeveritare, atëqëndror dhe lokal,” tha Bujar Maxhuni, zyrtar për demokratizim pranë OSBE-së. Ai shtoi se parimet e pajtimit ndëretnik dhe barazisë gjinore janë të integruara në të gjitha këto aktivitete.

Programe të veçanta janë hartuar me qëllim të inkurajimit të riintegrimit të komuniteteve pakicë në shoqëri dhe ofrimit të mundësive që zëri i tyre të dëgjohet në mënyrë të barabartë, përderisa qeveritë formulojnë politikat të cilat kanë ndikim në opinionin publik. Një rrjet i Qendrave Burimore të OJQ-ve dhe Qendrave të Komuniteteve, i shtrirë në mbarë Kosovën, është themeluar për të lehtesuar zhvillimin e një shoqërie civile aktive dhe për të nxitur pjesëmarrjen qytetare dhe pjesëmarrjen e komunitetit në jetën publike dhe në proceset vendimmarrëse, pa dallim etnje.

Për më tepër, Misioni përkrah dialogun në mes të grupeve aktive civile brenda Kosovës dhe me shoqëritë fqinje duke përfshirë ato serbe, malazeze dhe maqedone, të cilat kanë qëllime dhe sfida të ngjashme.

### Dialogu Qytetar

Diskutimet politike shpesh mbahen në fshehtësi apo larg syrit të publikut. Marrëveshjet e arritura megjithatë, gjithsesi se kanë ndikim në jetën e qytetarit të rëndomtë.

Dialog publik në mes të Prishtinës dhe Beogradit nuk ka pasur për një kohë të gjatë dhe kohëve të fundit një dialog i tillë po zyrtarizohet. Sido që të jetë, dialogu në mes njerzve të rëndomtë të shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova ka filluar të zhvillohet dhe të marrë formë shumë më herët.



“Ne besojmë fugishëm se ka ardhur koha që të integrohem i në shoqërinë kosovare,” tha Mileva Pesic, serbe nga Janjeva, mësimdhënëse në shkollën fillore të këtij fshati. Njerëzit si ajo janë një arsyse më shumë për të vazhduar aktivitetet e Dialogut Civil.

Organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe subjektet tjera qytetare në shoqëri veprojnë si kundërpeshë ndaj veprimtarisë qeveritare. Roli i tyre është të



Të rinjtë janë pjesë e rëndësishme e shoqërisë civile. OSBE-ja i jep rëndësi të madhe mobilizimit të tyre konstruktiv në proceset shoqërore.

Duke u marrë veçanërisht me rininë, Misioni ka inicuar krijimin e Kuvendeve komunale Rinore, detyrë e të cilave është që të sigurojnë se zëri i të rinjeve dëgjohet në proceset vendimarrëse, në nivel qeveritar qendror dhe komunal.

Në vitin 2005 dhe tutje, OSBE-ja do të vazhdojë të përkrahë sektorin joqeveritar, pasi që roli i këtij të fundit është i rëndësishëm për të siguruar normalizimin e marrëdhënieve në mes të grupeve etnike kosovare, për të lehtesuar përfshirjen e pakicave në shoqëri, për të avokuar për një qeveri transparente dhe të përgjegjshme, dhe në fund, për të përmirësuar kualitetin e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Kah mesi i vitit 2002, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Shoqatën Nëna Terezë nga Prishtina dhe Qendrën për Regionalizim nga Novi Sadi, kanë themeluar një iniciativë të pavarur shumëetnikë të organizatave joqeveritare të quajtur ‘Dialogu Qytetar’. Qëllimi i kësaj iniciative është të rithemelojë dhe fuqizojë lidhjet në mes të dy shoqatave, si dhe të ndihmojë në uljen e tensioneve të krijuara nga konfliktet e dhunshme në ish-Jugosllavi.

“Iniciativa ‘Dialogu Qytetar’ është një proces i ndërlikuar dhe delikat, por mbi të gjitha sfidues, i cili kërkon angazhim dhe energji,” thotë Don Lush Gjergji, personalitet i njohur fetar nga Kosova dhe autor i biografisë së Nënës Terezë, dhe në të njëjtën kohë bashkëdërejtë i bordit të Dialogut Qytetar.

Që nga fillimi, Dialogu Qytetar ka angazhuar më shumë se 700 persona dhe rreth 250 OJQ të rajonit (kryesisht nga Kosova dhe Serbia) të cilat punojnë në lëminë e rinisë, çështjeve gjinore dhe medias.

Projektet e tyre, si ato të quajtura “Gratë në biznes”, “Rinia dhe pacja” dhe “Gazetarët mund t’ia dalin mbanë” janë të drejtuara kah gjetja e gjuhjës së përbashkët për bashkëpunim dhe zgjidhje të problemeve siç është dekurajimi i femrave dhe të rinjeve nga pjesëmarrja në jetën politike e ekonomike, por edhe luftimi i stereotipeve përmes mediave.

“Jam vërtet i mahnitur me takimet e mbajtura nën organizimin e Dialogut Qytetar. Për herë të parë pas konfliktit, unë shoh të rinj nga Kosova dhe Serbia duke biseduar dhe planifikuar projekte të përbashkëta. Ata dijnë çfarë u nevojitet dhe dijnë si të merren me çështjet që i brengosin,” tha Jovan Komsic, profesor i sociologjisë në Universitetin e Novi Sadit, i cili ishte pjesëmarrës në disa takime.

Fillimisht, përmes diskutimeve publike, konferencave ndërkombëtare dhe takimeve rajonale, dhe më vonë përmes projekteve të vogla të finançuara nga donatorë tjerë të jashtëm, Dialogu Qytetar ka arritur bashkëpunim dhe partneritet bazë në mes të sektoreve joqeveritare në Kosovë dhe Serbi dhe në mes të komuniteteve të ndryshme etnike brenda Kosovës.

Gjatë katër viteve të fundit, aktivitetet e Dialogut Qytetar kanë tërhequr vëmendjen dhe kanë marrë përkrahjen e një numri të madh të organizatave të huaja dhe fondacioneve të cilat janë të angazhuara në proceset e demokratizimit. Në të ardhmen, Dialogu Qytetar mëton të përkrahë shumicën e projekteve të reja të OJQ-ve që do të mirren me lirinë e mediane, pjesëmarrjen në jetën publike dhe të drejtat e grave, si dhe pajtimin ndëretnik.



Zhvillimi i diversitetit kulturor ndihmon që të ketë pajtim ndër-etnik më të shpejtë.

## Ura qytetare

Qeveritë e reja komunale dhe ajo në nivel qëndror janë duke u shëndrruar gradualisht në struktura politike të përgaditura mirë.

Në vendet e zhvilluara, qeveritë me përvojë investojnë shumë energji në komunikim me qytetarët, përfshirë marrëveshjet e qytetarëve përfshirë komunitetet etnike. Ata bëjnë anketa përfshirë mendimet e qytetarëve përfshirë komunitetet etnike. Siç janë taksat dhe kujdesi shëndetësor, apo mbajnë mbledhje lokale përfshirë taksohet e qytetarëve përfshirë komunitetet etnike. Siç janë taksat dhe kujdesi shëndetësor, apo mbajnë mbledhje lokale përfshirë taksohet e qytetarëve përfshirë komunitetet etnike.

Deri para vitit 1999, në Kosovë bërtë e politikave dhe marrja e vendimeve kanë qenë të prira të bëhen në nivel qendror dhe nuk ka inkurajuar kulturë proaktive të ndërveprimit në mes të qeverive dhe qytetarëve. Ndikimi të cilin kanë mundur ta ushtronjë qytetarët shpesh ka qenë i kufizuar në nismat që mirreshin nga sindikatat e punës. Nismat tjera shpesh mospërfilleshin.

Si rezultat, nocionet si avokim, planifikim përfshirë pjesëmarrje apo konsultim publik janë ende kocepte të reja në Kosovë.

Duke vepruar si katalizator përfshirë krijuar marrëdhënie pune në mes të qeverive komunale dhe popullatës vendore, Misioni i OSBE-së në Kosovë në tetor të vitit 2004 ka filluar të implementoje projektin ‘Ura qytetare’.

“‘Ura qytetare’ ka përfshirë qëllim të shtojë ndërveprimin në mes të popullit dhe zyrtarëve vendorë, si dhe të përmirësosojë transparencën dhe kualitetin e shërbimeve të ofruara nga qeveritë komunale,” tha Jamie Valles, zyrtar përfshirë komunitetet etnike. Siç janë taksat dhe kujdesi shëndetësor, apo mbajnë mbledhje lokale përfshirë taksohet e qytetarëve përfshirë komunitetet etnike.

Projekti, fillimisht i zbatuar në Deçan, së shpejtë ka filluar të zbatohet edhe në dy komuna tjera të këtij rajoni, në Pejë dhe Istog. Në këtë projekt janë angazhuar tri OJQ vendore nga këto komuna të cilat edhe e udhëheqin zbatimin e tij.

“Projekti ‘Ura qytetare’ ka përfshirë qëllim themelin e një mekanizmi që do të siguron praktikimin efektiv të parimeve demokratike, dhe t’iu mundësuar qytetarëve të kenë ndikim në procesin e vendim-marrjes në komunë,” tha Adem Lushaj nga Shoqata e Intelektualëve të Pavarur nga Deçani, shoqatë kjo e përfshirë në zbatimin e projektit.

Si pjesë e projekteve, në tri komuna janë themeluara Grupe Drejtuese të ‘Urës qytetare’. Të përbëra nga reth 10-11 anëtarë apo personalitetë të dalluara nga sektori joqeveritar dhe institucionet vendore shkolllore, mediale dhe qeveritare. Këto grupe identifikojnë dhe adresojnë çështjet brengosëse në nivel komunal, siç janë cilësia e kujdesit shëndetësor, shkolliimi fillor dhe i mesëm apo mbledhja e taksave.

Puna e tyre ndihmohet nga Grupet Punuese të ‘Urës qytetare’ të përbëra nga aktivistë të rinj të cilët sjellin energji dhe entuziazëm në projekt. Ata i shikojnë çështjet nga tri aspekte të ndryshme: zbatimi i legjislacionit komunal, cilësia e shërbimeve të ofruara nga autoritetet lokale si dhe transparensa në vendimmarje dhe zbatim. Grupet pastaj përpilojnë raporte analitike, të cilat më pas shqyrtohen dhe përdoren përfshirë komunitetet etnike. Ata, po ashtu llojnjë përfshirë zbatimin e komunitetet etnike. Ata, po ashtu llojnjë përfshirë zbatimin e komunitetet etnike.



Duke vepruar si katalizator në themelin e raporteve të punës në mes të qeverive komunale dhe popullatës lokale, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka filluar në tetor të vitit 2004 të implementoje projektin “Ura qytetare”.

## PËRKRAHJA E SHOQËRISË CIVILE

ofron kryesisht përkrahje financiare dhe këshilla.

Si rezultat, zyrtarët komunalë mësojnë përfitimet e pjesëmarrjes në bërjen e politikave, derisa qytetarët i zhvillojnë kapacitetet e tyre për të vepruar si monitorues dhe këshilltarë të qeverisë. Për më tepër, të dy palët bëhen shumë më të vetëdijshme për çështjet e ngritura nga raportet analitike.

Çështja më e rëndësishme është se zyrtarët vendor kanë filluar të veprojnë. Pas rekomandimeve në Deçan, për shembull, institucionet shëndetësore të komunës kanë përmirësuar qasjen e tyre në ofrim

të shërbimeve, respektim të orarit të punës, si dhe procedura për planifikim të buxhetit dhe miratim, si dhe mbikëqyrje të shpenzimeve në klinika dhe ambulanca.

Për më tepër, seancat e Kuvendeve Komunale si dhe nga personat që kërkojnë shërbime nga komuna shpesh u referohen rekomandimeve të bëra nga Grupet Drejtuese të ‘Urës qytetare’. Sipas Mehmet Bojkaj, anëtar i Kuvendit Komunal të Deçanit, autoritetet duhet t'i kuptojnë rekomandimet e Grupeve Drejtuese si mjet ndihmës dhe konstruktiv e jo vetëm si kritikë. “Ura qytetare” në Deçan nuk duhet të jetë vetëm projekt por organ i përhershëm funksional, ” shtoi ai.

Duke iu falënderuar ‘Urës qytetare’, pjesëmarrja e qytetarëve dhe avokimi nuk janë më koncepte të panjohura në këto komuna. Në vitin 2006, Misioni i OSBE-së do të përkrahë zbatimin e këtij projektit edhe në një numër komunash në mbarë Kosovën.



‘Hareja’ u ndihmon grave në krijimin e vetë-besimit, duke ju ofruar atyre mundësi për shkollim.

Përveç një numri të OJQ-ve nga Kosova, ‘Hareja’, po ashtu, është pjesë e rrjetit rajonal dhe ka bashkëpunim të mirë me OJQ-të nga ish republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Bosna e Hercegovina.

Për të vetëdijësuar gratë për të drejtat e tyre dëshironi përkrahje financiare, përfundimisht përmirësimi i pozitës së tyre në shoqërinë e Kosovës, në vitin 2004 ‘Hareja’ dhe Misioni i OSBE-së kanë zbatuar projektin ‘Zeri i Grave’. Është mbajtur një seri e radioprogramave ku janë prezantuar gra të shquara nga bota dhe nga vendi, të cilat mbajnë pozita me përgjegjësi në administratën komunale. Programet kanë mbuluar tema siç janë roli i grave në komunitete lokale dhe qeveri komunale, në politikë dhe në zgjedhje, gjendja e grave në lidhje me arsimimin, përkujdesjen shëndetësore dhe mirëqenien sociale.

Aktualisht, Misioni është duke e përkrahur ‘Harenë’ në implementimin e një projekti që ka për qëllim të vetëdijësosjë gratë nga komunitete të ndryshme etnike në zonat rurale se si funksionojnë institucionet komunale dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetare. Projekti përfshin edhe autoritetet komunale dhe vetëdijëson ata për nevojat dhe brengat e qytetarëve vendorë dhe nevojën për ndërveprim në mes të zyrtarëve dhe popullatës rurale, grave në veçanti.

Ky projekt, i paraparë të përfundojë në fund të dhjetorit të vitit 2005, përfshin shtatë seminare të organizuara për gratë nga zonat rurale në rajonin e Rahovecit. “Seminaret do të pasohen me një tryezë të rrumbullakët që do t'iu ofrojë grave mundësi për të diskutuar brengat e tyre të përbashkëta të identifikuara përmes seminareve me zyrtarët komunalë,” tha Annett Gerber, zyrtare për demokratizim nga zyra e OSBE-së në Rahovec. “Ato do të kenë mundësinë edhe të propozojnë hapa konkretë për të adresuar këto brenga,” shtoi ajo.

“Përkrahja e punës së një partneri të dedikuar, të pavarur dhe përgjegjëse të shoqërisë civile gjithmonë sjell rezultate. Ndihem e privilegjuar që kam pasur rastin të punoj me ‘Harenë’ dhe jam e bindur se ato do të sjellin edhe shumë më shumë ndryshime pozitive,” përfundoi Gerber.

### Rrjeti multiethnik i grave

‘Hareja’ është një organizatë e grave nga Rahoveci që rinisi punën në vitin 1999. Sot, kjo organizatë punon fuqishëm për përmirësimin e pozitës së grave dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve në jetën shoqërore. ‘Hareja’ është aktive në sektorin e shkollimit dhe të shëndetësisë dhe zbaton projekte që gjenerojnë të hyra të vogla dhe projekte për zhvillim bujqësor për gratë në gjendje të vështirë materiale dhe për familjet e tyre. Ajo, po ashtu, ofron trajnime për ngritje të kapaciteteve për gratë dhe vajzat nga zonat rurale dhe urbane të komunës.

Në vitin 2003, ‘Hareja’ iu drejtua OSBE-së me një ide për themelimin e një rrjeti lokal multiethnik të grave. Pas një bashkëpunimi dhe bashkërendimi të ngushtë, u zhvillua një koncept i realizueshëm i projektit, dhe me pas edhe u themelua një rrjet i përbërë nga dy organizata serbe, një shqiptare dhe një rome të grave kosovare.

Shumë shpejt, Rrjeti Lokal i Grave mbledhi fonde për të ndërtuar një qendër të re për gratë, duke ofruar aktivitete shkolllore joformale të ndryshme për gra dhe fëmijë, një kopsht për fëmijë dhe shërbim të gjinekologjisë e të mjekësise familjare. “Gra nga të gjitha komunitetet në rajon i shfrytëzojnë shërbimet e qendrës dhe ndjekin ngjarjet që ne i organizojmë,” tha Judith Brand nga OJQ-ja gjermane Amica, organizatë anëtare e rrjetit të grave që ka ndihmuar në rithemelimin e ‘Haresë’.

## Programi për edukim demokratik

Aktualisht, më shumë se gjysma e popullatës kosovare është nën moshën 26-vjeçare dhe më shumë se 70% nën moshën 35-vjeçare. Në përgjithësi, Kosova është një shoqëri shumë e re, ku të rinjtë kanë potencial të madh për të përcaktuar ambientin ku dëshirojnë të jetojnë.

Arsimimi ka rol vendimtar në zhvillimin e të rinjve. Përveç parimeve morale dhe vlerave që rinia i trashëgon nga familja, shumë më shumë mësohet gjatë shkollimit dhe ndjekjes së institucioneve arsimore.

Për këtë arsy, Misioni i OSBE-së, si shtyllë e tretë e administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë, mandati i së cilës është ndërtimi i institucioneve dhe demokracisë, përpinqet të rrënjosë vlera demokratike tek të rinjtë, duke i ndihmuar institucionet e arsimit në ofrimin e programeve cilësore për edukim demokratik.

Kjo, meqjithatë, mund të mos jetë e mjaftueshme, pasi që mungesa e vetëdijes dhe paragjykimet që grupet e ndryshme etnike kanë për njëra tjetrën, sjellin deri te ndarja dhe diskriminimi. Kjo ka efekt negativ, posaçërisht tek të rinjtë dhe komunitetet që përbëjnë pakicat në rajone të ndryshme të Kosovës (kryesisht serbët dhe romët e Kosovës, por edhe shqiptarët).

Për këtë arsy, Misioni i qaset çështjes së arsimimit nga disa kënde dhe mundohet t'i përfshijë të gjitha palët e interesit - duke filluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjise (MASHT) dhe Shoqata e Prindërve dhe Mësimdhënësve, deri te mësimdhënës së profesorët dhe, çka është më e rëndësishmja, vetë të rinjtë.

"Programi ynë për Edukim Demokratik është i hartuar ashtu që t'i kundërvihet diskriminimit, të promovojë tolerancën dhe të sigurojë një qasje të paanshme në sistemin arsimor për të gjitha komunitetet e Kosovës," tha Mohamed Sagdati, Zyrtar për Demokratizim i OSBE-së, i cili edhe e menaxhon programin.

Ky program, po ashtu, ka për qëllim që të kërkojë përfshirje të prindërve dhe mësimdhënësve dhe t'i bëjë ata partner implementues. Faza testuese ka filluar në Prizren në fillim të marsit të vitit 2005. Përafërsisht 40 nxënës të shkollave të mesme, mësimdhënës,

prindër dhe drejtore shkollash, kanë ndjekur një numër trajnimesh për ndërtimin e tolerancës, për modelet evropiane të shoqërisë demokratike, për përfshirjen e të rinjve në politikë dhe për shkathtësitë e avokimit. Aktivitetet janë organizuar për të lehtësuar shoqërimin në mes të rinisë së komuniteteve shqiptare, serbe, rome dhe boshnjake të Kosovës.

Hapi i ardhshëm ishte organizimi i një takimi në mes të të rinjve nga Prizreni dhe Ferizaji, që të dyja këto rajone shumëetnikë, në po të njëjtin muaj. OSBE-ja, MASHT-i dhe Shoqata e Prindërve dhe Mësimdhënësve e Ferizajit, kanë organizuar një vizitë në një shkollë të mesme të Ferizajit nga një grup i nxënësve nga Prizreni. "Qëllimi i vizitës ishte që të forcohet lidhja ndërkulturore në mes të nxënësve nga mjedise të ndryshme, për të themeluar marrëdhënie dhe miqësi të reja, si dhe për të promovuar tolerancën," tha Mustafë Beqiri, kryetar i Shoqatës.

Që nga fillimi i vitit 2004, OSBE-ja ka këshilluar dhe ka ndihmuar Shoqatën e Prindërve dhe Mësimdhënësve të Ferizajit, në përpjekjet e tyre për të rritur bashkëpunimin në mes të shkollave të Kosovës.

Programi është zgjeruar në më shumë zona të komunave të Ferizajit dhe Kaçanikut, dhe nga nëntori i vitit 2005, Planprogrami Plotësues për Edukim Demokratik është përfshirë në tetë shkolla të mesme për nxënës të klasave të nënta, rreth 600 nxënës, të cilët deri më tani nuk kanë pasur rast të kenë edukatë qytetare adekuate. Për të siguruar fillim të efektshëm të planprogramit, janë organizuar seminare dhe trajnime të ndara për mësimdhënës dhe prindër në secilën nga tetë shkollat.

Qëllimi kryesor nuk është implementimi i një iniciative për edukim demokratik vetëm në komunitat e Ferizajit dhe Kaçanikut, por për ta përkrahur MASHT-in në përfshirjen e "praktikave të mira", të mësuara nga tetë shkollat e para, në shkolla tjera të mesme në Kosovë për përfitim afatgjatë të rinisë edhe në të ardhmen.

MASHT-i, partner në këtë program nga fazat e tij fillestare, do të jetë faktor kyç për të siguruar se edukimi demokratik iu ofrohet nxënësve të të gjitha shkollave të mesme në Kosovë.



Prindërit dhe mësimdhënësit janë partnerët kryesorë në zbatimin e Programit të OSBE-së për Edukim Demokratik, i cili është në shërbim të të rinjve nga të gjitha komunitetet etnike.

## TË RINJTË

Shpërthimi i dhunës në mars të vitit 2004, ka treguar se tensioni nën sipërfaqe vazhdon të paraqesë një pengesë të madhe në zhvillimin e demokracisë në Kosovë. Të rinjtë nga komunitete të ndryshme etnike, janë parë duke marrë pjesë në trazira dhe demonstrata të dhunshme në mbarë Kosovën, duke u kushtuar shumë pak kujdes praktikave demokratike dhe të të drejtave të njeriut.

Për të përmirësuar këtë, Misioni i OSBE-së në Kosovë ka shtuar angazhimin në aktivitetet dhe projektet që kanë të bëjnë me të rinjtë. Misioni ka implementuar projekte në mbarë Kosovën të cilat kanë për qëllim të përfshijë të rinjtë në procese demokratike dhe të ndërtimit të tolerancës.

Misioni punon me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së IPVQ-së për të përfshirë mësimin mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut në arsimin fillor dhe të mesëm dhe ka përkrahur punën e Fakultetit Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe Mitrovicës.

OSBE-ja po ashtu ndihmon në ofrimin e mundësive edukative për të rinjtë, anëtarët e grupeve etnike në pozita më të disfavorshme – romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit.

Në kontakt të drejtpërdrejtë me të rinjtë në Kosovë, Misioni ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në edukatën qytetare të të rinjëve nga të gjitha komunitetet, dhe ka themeluar 11 Kuvende Rinore, si dhe tetë Klube Rinore të të Drejtave të Njeriut në nivelin komunal.

Së bashku me përpjekjet tona për ngritje të kuadrove me Zyrtarët Komunal për Çështje Rinore, janë shtuar në mënyrë të konsiderueshme edhe kanalet në dispozicion të të rinjve për diskutime të arsyeshme dhe politika paqësore.

Në nivelin qendror, Misioni përkrah punën dhe ndihmon zhvillimin profesional dhe politik të të rinjëve që kryejnë praktikën në Kuvendin e Kosovës dhe punojnë për grupin parlamentar të partisë së tyre.

Misioni ka implementuar edhe projekte përmes të cilave të rinjtë e të gjitha komuniteteve kanë marrë pjesë në trajnime dhe diskutime të përbashkëta, debate për standarde, iniciativat për të inkurajuar lirinë e lëvizjes dhe integrimin e fëmijve romë, ashkali dhe egjiptas në arsim. Mungesa e përgjithshme e gatishmërisë për t'u angazhuar në dialog ndëretnik mbetet pengesë. Megjithatë, shumë e më shumë vullnetarë për përfshirje civile paraqiten për të tejkular barrierat e mbeturat.

Duke kuptuar demokracinë më mirë dhe duke treguar gatishmëri të shtuar për t'u angazhuar dhe dëgjuar komunitetet tjera, vetë të rinjtë janë duke e ndihmuar Kosovën të marr hapa të vërtetë drejt një shoqërie paqësore dhe demokratike.



Të rinjtë e Kosovës janë promovuesit më të mirë të tolerancës ndër-etnike. Misioni i OSBE-së zbatuesit një numër të projekteve në përkrahje të të rinjëve.



Parada për standarde e organizuar nga Kuvendi Rinor i Lipjanit në tetor të vitit 2005 ka prezantuar standarde për Kosovën në mënyrë kreative dhe originale.

### Kuvendet rinore

Nisma për të krijuar 'Kuvendet rinore' është një ndër elementet kryesore të programit për rini të Misionit të OSBE-së. Të rinjtë nga mosha 15 deri 20-vjeçare mësojnë më shumë për vlerat dhe proceset demokratike, si dhe shkathtësitë e nevojshme për pjesëmarrje në shoqëri demokratike. Si i tillë, ky projekt ndihmon në përfshirjen e të rinjve në procese demokratike (edhe pse akoma kërkohet përmirësim i dukshëm nga institucionet) si dhe integrimin e komuniteteve, pasi që 'Kuvendet rinore' përfshijnë shqiptarë, serbë, romë, ashkali, boshnjakë, kroatë, goranë dhe turq.

Struktura qendrore e projektit është një organ i përbërë prej 25 nxënësve të shkollave të mesme në secilën nga 11 komunat ku janë themeluar Kuvendet Rinore – Dragash, Gjilan, Kamenicë, Leposavic, Lipjan, Mitrovicë, Prizren, Podujevë, Rahovec, Suharekë, dhe Vushtrri. Anëtarët e Kuvendeve Rinore imitojnë punën e Kuvendeve Komunale dhe komisioneve çdo dy javë. "Gjatë vitit, anëtarët kanë votuar për kryetar, nënkyetar, dhe shef të ekzekutivit dhe ata krijojnë komisione dhe grupe punuese që adresojnë çështjet më urgjente për të rinjtë në rajonin e tyre, siç janë ambienti, papunësia dhe standarde shkollore," tha Aleksandar Bursac, Asistent i Programit të OSBE-së për Kuvendet Rinore.

Për të ndihmuar zhvillimin që nevojitet për të arritur këtë rezultat me një grup të tē rinjëve të cilët nuk kanë ndjekur gati fare edukatë qytetare, kërkohet ngritje e dukhme e kuadrove. “Disa trajnime përfshirin e funksionet dhe strukturat e komunës ofrohen nga stafi i OSBE-së, të tjerat që kanë të bëjnë me fjalimet para publikut, ndërtimin e ekspertit, menaxhimin e konfliktit, organizimin e OJQ-ve dhe mbledhjen e fondeve ofrohen nga ekspertët vendorë,” shtoi Bursac.

Deri më tani, kuvendet kanë implementuar gati 20 projekte, duke filluar nga fushatat përvetësimi përfshirin e ambientit deri tek projektet të cilat inkurajojnë njerëzit të votojnë. Kuvendet Rinore kanë implementuar një projekt përfshirin e inkurajuar turizmin në Dragash, kurse aktualisht janë duke e punuar një dokumentar në lidhje me lirinë e lëvizjes përfshirin e gjitha komunitetit.

Përveç kësaj, nga data 19 deri më 26 gusht të vitit 2005, 250 anëtarë të Kuvendeve Rinore janë mbledhur në Zhabljak, Mal të Zi, për seminarin e tretë të Kuvendeve Rinore ku kanë diskutuar dhe

janë pajtuar përfshirin e komuniteteve të cilat aktualisht ballafaqohet rinia në Kosovë – papunësia, mungesa e hapësirave përfshirin e sportit dhe kulturës përfshirin e pamjaftueshme në proceset vendim-marrëse, martesa e hershme, mungesa e qasjes në ndërtesa shkolllore cilësore, pakujdesia ndaj ambientit dhe kufizimet në lëvizje dhe shoqëri. “Ata kanë formuluar rekomandime përfshirin e UNMIK-un, IPVQ-të, bizneset lokale dhe shkollat përfshirin e adresuar këto probleme, si dhe projekte konceptuale përfshirin e t'u implementuar nga Kuvendet Rinore në vitin e ardhshëm,” tha Sehadin Shok, zyrtar i OSBE-së.

Të gjitha këto aktivitete janë shumë të rëndësishme përfshirin e anëtarëve përfshirin e shkollorëve cilësore, pakujdesia ndaj ambientit dhe kufizimet në lëvizje dhe shoqëri. “Ata kanë formuluar rekomandime përfshirin e UNMIK-un, IPVQ-të, bizneset lokale dhe shkollat përfshirin e adresuar këto probleme, si dhe projekte konceptuale përfshirin e t'u implementuar nga Kuvendet Rinore në vitin e ardhshëm,” tha Sehadin Shok, zyrtar i OSBE-së.

Për më shumë informata përfshirin e Kuvendeve Rinore vizitonit

[www.youthassemblies.com](http://www.youthassemblies.com)

## Mësimi plotësues dhe projekti përvetësimi e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve

E drejta përfshirin e shkollimit përvetësimi e romëve, ashkalinjve dhe egjiptasve është e garantuar me Deklaratën Universale dhe Konventën Evropiane të tē Drejtave të Njeriut.

Por, të rinjtë dhe fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë (RAE) nuk janë në pozitë që këtë të drejtë ta gëzojnë plotësisht. Kjo ndodh përfshirin e shkak se ata shpesh nuk mund të përkrahen nga prindërit e tyre dhe detyrohen të punojnë dhe ngase diskriminohen në baza ditore.

OSBE-ja po mundohet të korrigojë këtë situatë. Ndërhyrja më e fundit dëshiron që të përmes projektit Mësimi Plotësues, ofron kurse intensive të shkollimit, si shtesë e planprogramit të rregullt përfshirin e komuniteteve RAE. “Mosnjohja e tē shkruarit në gjuhën shqipe është pengesë në vijimin e shkollimit dhe në arritjen e suksesit akademik. Projekti jonë ka përfshirin qëllim të ngrisë nivelin arsimor të fëmijëve përfshirin e tui mundësuar integrimin në rrjetin e shkollimit,” tha Saskia Marsh, menaxhere e projektit.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, afro 950 fëmijë romë, ashkali dhe egjiptas nga mosha 6-15-vjeçare janë regjistruar përvetësimi plotësues në tetë komuna – Gjakovë, Istog, Lipjan, Pejë, Prishtinë, Prizren, Suharekë dhe Shtime – që nga fillimi i projektit në shtator 2004. Vetëm në komunën e Prizrenit, 15% e nxënësve të regjistruar kanë qenë në gjendje që, pa pasur shkollim paraprak, të kyçen në orët e rregullta me bashkëmoshatarët e tyre nga komunitetet tjera. “Ky është një hap i madh në rruge të drejtë integrimit dhe përvetësimit të anëtarëve të rinj të një grupi etnik të marginalizuar tradicionalisht,” shtoi Marsh.

Përveç ofrimit të ndihmës përvetësimi plotësues, Misioni i OSBE-së në vitin 2004 ka zbatuar projektin “përvetësimi plotësues të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas” në Prizren. “Qëllimi i projektit ka qenë të rritet pjesëmarrja e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas në proceset demokratike, si dhe të rrisë besimin politik të komuniteteve të tyre,” tha Zillha Nurkollari nga zyra e OSBE-së në Prizren.

Të rinjtë romë, ashkali dhe egjiptas, kryesisht nxënës të shkollave të mesme, kanë shtuar njohuritë e tyre në fushën e strukturave komunale, përdorimin e mediave, hartimin e projekt-propozimeve dhe avokimin përfshirin e çështje gjinore. Në anën tjetër, komunitetet e tyre kanë pasur rastin të diskutojnë brengat e tyre me institucionet komunale, kryesisht mundësitet përvetësim, qasjen në mirëqenie sociale, si dhe qasjen në shkollim përfshirin e komuniteteve.

Dhe, derisa akoma ekziston nevojë përvetësimi plotësues, Misioni i OSBE-së në vitin 2004 ka zbatuar projektin “përvetësimi plotësues të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas” në Prizren. “Qëllimi i projektit ka qenë të rritet pjesëmarrja e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas në proceset demokratike, si dhe të rrisë besimin politik të komuniteteve të tyre,” tha Zillha Nurkollari nga zyra e OSBE-së në Prizren.



Orët e përvetësimit të rinjve romë, ashkali dhe egjiptas në sistemin e rregulltë shkollor.

### Ruga Sesam

Misioni i OSBE-së dhe Zyra e UNICEF-it kanë sjellë në Kosovë 'Rrugën Sesam', njëren ndër serialet më të suksesshme përfmijë në botë.

Me sjelljen e botës së kukullave në Kosovë, siç janë Erni dhe Berti, Elmo dhe Zogu i Madh në Kosovë, synohej të sillej një mjet edukues që e përdor televizionin si mediumin kryesor duke e kombinuar argëtimin me mësimin.

52 episodat e zgjedhura janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë plotësuar me 26 sekuencia filmike të shkurtëra të prodhua në Kosovë të cilat përshkruajnë situata të përditshme, që karakterizojnë komunitetë të ndryshme që jetojnë këtu.

Në dhjetor të vitit 2004, transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka filluar transmetimin javor të serialit në gjuhën shqipe dhe serbe, 'Ruga Sesam', përkatësisht 'Ulica Sezam'.

"Episodat e 'Rrugës Sesam' iu dedikohen fëmijëve nga mosha 3-6-vjeçare dhe kanë përfshirë qëllim t'iu mësojë atyre tolerancën dhe respektin përfshirë etnicitetet dhe kulturat e ndryshme," tha Angela Tenbruck, koordinatore e këtij projekti në OSBE. "Ky është programi i parë i këtij lloji dhe është □

Qëllimet edukative përfshirë këto episoda janë caktuar në janar të vitit 2004. Në atë kohë, UNICEF-i, Misioni i OSBE-së, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Workshopi Sesam nga Nju Jorku dhe disa OJQ vendore të cilat kanë programe përfshirë zhvillimin të fëmijëve kanë mbajtur disa takime pune. "Një dokument që ka treguar qëllimet edukative dhe një planprogram i veçantë përfshirë projektin e Rrugës Sesam ka dalë si rezultat i këtyre takimeve," tha Lucia Elmi, Koordinatore e projektit në Zyren e UNICEF-it në Kosovë.

Sipas saj, planprogrami ka përfshirë temat e shumëlojshmërinë njerëzore dhe përfshirë themën e shumëlojshmërisë etnike, kulturore dhe fetare, deri tek emocionet njerëzore, gëzimi, hidhërimi dhe marrëdhëni shoqërore.

Përfshirë rithekssuese porositë kryesore dhe përfshirë njësoftuar fëmijet parashkollorë dhe ata që vijojnë shkollimin e hershëm fillor me Rrugën Sesam, UNICEF-i ka prodhuar 15,000 pakos përfshirë nxënës dhe 1,500 pakos përfshirë mësimdhënhës njerëzore. Secila pakos përbëhet nga një libër pune, letra përfshirë mësimdhënsore, numrave dhe metër përfshirë matje të gjatësise, që iu dedikohen fëmijëve prej moshës 3-6-vjeçare. Pakoja e mësimdhënsës përfshirë edhe një libër udhëzues përfshirë mësimdhënsorë.

Zonja Besa Shehu, mësuese parashkollore në Prishtinë, tha se i çmon shumë materialet e ilustruara dhe se fëmijët tanimë janë familiarizuar me personazhet e Rrugës Sesam. "Këto ditë, ata po kënaqen duke mësuar me shokët e tyre prej gëzofit," tha ajo.

Përmes momenteve, sinjalë i transmetuesit publik RTK nuk arrin te të gjithë fëmijët pasi që nuk mbulon disa pjesë malore. "Përfshirë mbushur këto zbratzësira, ne kemi marrë leje dhe kemi arritur një marrëveshje përfshirë drejtat autoriale me Rrugën Sesam në Nju Jork dhe tanë televizionet lokale siç janë DTV-ja, TV Mosti dhe RTV Herci e emetojnë serialin përfshirë fëmijët jashtë sinjalit të RTK-së," tha Znj. Tenbruck.

Këto tri televizione mund të ndiqen nga fëmijët serbë në rajonin verior dhe jug-lindor të Kosovës.

Sidoqoftë, disa fëmijë njerëzore në Kosovë jetojnë në rajone ku nuk arrin gati asnjë sinjal televiziv dhe nuk kanë as sinjal televiziv tokësor. Fshati Çabëri njerëzore në komunën e Zubin Potokut, komunë me shumicë serbë, dëshiron që të ketë njësinë e parë përfshirë mësimdhënsore. "Mësimdhënsori i mire përfshirë këtë mungesë sinjalë. Në këto vendbanime, Misioni i OSBE-së ka organizuar kinema lëvizëse që i vizitojnë fshatrat çdo javë dhe i shfaqin episodat.

52 episodat mbulojnë 12 muaj, nga dhjetori i vitit 2004 deri në dhjetor të vitit 2005. Përfshirë një mësimdhënsore përfshirë mësimdhënsoren e Rrugës Sesam, që i vizitojnë fshatrat çdo javë dhe i shfaqin episodat.



Fëmijët e Kosovës luajnë dhe mësojnë me personazhet e Rrugës Sesam në shkollë dhe shtëpi.

## Edukimi për të drejtat e njeriut

OSBE-ja ndihmon Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në përfshirjen e të drejtave të njeriut në lëndën e edukatës qytetare.

Ndërtimi i institucioneve demokratike, si dhe mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, janë detyrë kryesore e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Kjo detyrë, shpesh merret si diçka që ka të bëjë vetëm me politikën apo politikanët, por janë njerëzit e thjeshtë ata që e përbëjnë shoqërinë dhe e përcaktojnë cilësinë e saj. Me fjalë të tjera, vetëm politikanët dhe politika, edhe pse shumë të rëndësishëm, nuk mund t’krijojnë një shoqëri demokratike që përkrah të drejtat e njeriut. Këto vlera duhet të pranohen nga qytetarët e thjeshtë. Përveç kësaj, për të pasur një kulturë të suksesshme të të drejtave të njeriut, është e domosdoshme që të gjithë të mësojnë të shfrytëzojnë ligjin për t’i mbrojtur të drejtat e tyre.

Dhe, në vend që këto vlera të pranohen në moshë më të shtyrë, të drejtat e njeriut dhe demokracia kuptohen më së miri në moshën e re. Në fakt, mësimi për të drejtat e njeriut mund të fillojë në qendrat parashkollore dhe duhet të vazhdojë gjatë shkollës filllore, të mesme dhe arsimit të lartë.

Sistemi arsimor i Kosovës dhe planprogrami i hartuar pas konfliktit të vitit 1999 dhe vendosjes së Administratës së Përkohshme të OKB-së, ka qenë më i përparuar nga ai i Jugosllavisë. Sidoqoftë, mësimi i të drejtave të njeriut nuk ka qenë i përfshirë.

Në përpjekje për t’i përfshirë të drejtat e njeriut si lëndë në shkollat filllore, në vitin 2001 Misioni i OSBE-së së bashku me Këshillin e Evropës, ka organizuar fushatën ‘Kalendar i të Drejtave të Njeriut’. Zyrtarë të OSBE-së vizituan shkolla në mbarë Kosovën duke shpjeguar dhe diskutuar të drejtat e njeriut, si dhe duke u ndihmuar fëmijëve të shprehen me fjalë të tyre se çfarë domethënien kanë këto të drejta për ta. Ata që kanë qenë më kreativë me ide janë përfshirë në faqet e kalendarit, i cili më pas është eksposuar në shkolla dhe qendra kulturore e të komuniteteve në Kosovë.

Por, kjo përpjekje nuk ka qenë e vetëqëndrueshme. Mësimi i të drejtave të njeriut nuk ka mundur t’u lihet zyrtarëve të OSBE-së.

Në vitin shkollor 2003/2004, një pilot-projekt për Mësimin e të Drejtave të Njeriut është organizuar në tërë territorin e Kosovës, duke sjellë libra pune mbi të drejtat e njeriut për nxënës dhe libra udhëzues dhe të metodologjisë së mësimdhënies për arsimtarë në 70 shkolla. Të gjitha këto materiale janë hartuar nga ekspertët e OSBE-së në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

“Ky vit mësimor u tregua shumë efektiv. Vlerësimi i pilot projekteve ka qenë pozitiv dhe me përmirësime të vogla të materialeve, MASHT-i ka vendosur ta përfshijë mësimin e të drejtave të njeriut në planprogramin e edukimit qytetar për klasat e 6-ta,” thotë Ronald Hooghiemstra, shef i njësisë për ngritjen e kuadrove në Departamentin e të Drejtave të Njeriut të OSBE-së.

Viti shkollor 2004/2005 ka shërbyer për të rishikuar përbajtjen, hartimin dhe shtypjen e materialeve mësimore që do të jenë të



*Edukimi për të drejtat e njeriut më së miri përfshihet në arsimin shkollor. Misioni i OSBE-së i ndihmon autoritetet lokale në hartimin e plan-programit për të drejtat e njeriut.*

mjaftueshme për dy vitet shkollore në vijim (rreth 90,000 libra për nxënës, 2,000 udhëzues për arsimtarë dhe libra të metodologjisë).

Që nga shtatori i vitit 2005, të gjithë nxënësit e klasës së gjashtë në Kosovë do të mësojnë për të drejtat e njeriut dhe domethënien e këtyre të drejtave për jetërat e tyre dhe të familjeve. Për të siguruar cilësinë e mësimdhënies, MASHT-i dhe OSBE-ja do të trajnojnë afro 2,000 arsimtarë të edukatës qytetare mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe substancës së planprogramit të të drejtave të njeriut, duke përdorur shtatë qendrat rajonale për trajnim të MASHT-it.

Megjithatë, akoma ka probleme në këtë fushë. Ato burojnë nga gjendja e ndërlikuar politike dhe ekzistenza e strukturave paralele. Shkollat në gjuhën serbe nuk bashkëpunojnë me MASHT-in dhe nuk punojnë sipas planprogramit të saj (ato punojnë sipas planprogramit që aplikohet në Serbi).

Edhe pse ekziston një draft-përkthim i këtyre materialeve për të drejtat e njeriut në gjuhën serbe, OSBE-ja akoma nuk është në gjendje të arrijë një marrëveshje për miratim dhe finalizim të tyre, në mënyrë që të përdoren në shkollat në gjuhën serbe. Për këtë arsy, fëmijëve që i ndjekin këto shkolla iu është mohuar qasja në orët e të drejtave të njeriut.

Për më tepër, shkollat në gjuhën boshnjake mund të kenë vonesa në mësimin e të drejtave të njeriut derisa t’u ofrohen tekstet e përkthyera.

Një çështje tjeter është çka do të ndodh me mësimin e të drejtave të njeriut kur librat e siguruar nga OSBE-ja për dy vite shkollore do të harxhohen?

Këto pyetje janë çështje për të cilat duhet të përkujdesen politika dhe politikanët, gjatë diskutimit dhe aprovizimit të buxhetit të ardhshëm për arsimimin e rinisë së Kosovës.

## EDUKIMI DHE ZHVILLIMI I POLICISË

### "Policia është populli, dhe populli është policia"

Këto janë fjalët e para që secili kadet i policisë i ka parë dhe lexuar kur ka hyrë në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSPK) të udhëhequr nga OSBE-ja. Ky është himni për trajnimin e forcave policore bazuar në parimet demokratike dhe standartet më të larta të integrititetit.

SHSPK-ja është themeluar në shtator të vitit 1999 me qëllim të krijimit të forcave moderne policore që do të rivendoste besim në hyrjen në fuqi të ligjit dhe në mënyrë efektive të zbatojë parimet e ligjit bazuar në policinë në bashkëpunim me komunitet. Duke ditur që ka filluar punën në kohën kur asnjë institucion tjetër nuk ka funksionuar, mundet shumë lehtë të konsiderohet si një nga sukseset më të mëdha pas konfliktit në Kosovë.

SHSPK-ja ka filluar me pak më shumë se përkushtimin dhe vizionin e anëtarëve të mëhershëm të statit. Angazhimi dhe financimi i OSBE-së kanë qenë të dukshme në aspektin e rezultateve të arritura, por sipas Stiv Benet, i cili është Drejtëor i shkollës që nga fillimi, është me rëndësi që të njihet roli individual që luan çdo oficer i SHPK-së. "Pa marrë parasysh sa e mirë është shkolla dhe sa të mirë janë instruktorët, nëse nuk keni njerëz me integritet dhe kapacitet themelor, gatishmëri dhe dëshirë për të mësuar, ju kurrë nuk mund të arrini rezultate."

Klasa e parë e kadetëve ka mbaruar kursin në tetor të vitit 1999, ndërsa klasa e 31-të do të diplomojë në fund të vitit 2005 – përafërsisht 7,500 oficerë të rinj të policisë. Ndërkohë, SHSPK-ja ka zhvilluar riçertifikimin e kurseve të avancuara të oficerëve të Shërbimit Policor të Kosovës të cilët tash janë në rrugë dhe i shërbejnë popullit. Kjo të bënë të kuptohet se çdo polic që e shihni dhe me të cilin mund të keni kontakt në Kosovë ka qenë i trajnuar nga OSBE-ja.

Më e rëndësishmja është që duke iu falenderuar përpjekjeve të OSBE-së, sot femra dhe meshkuj nga të gjitha komunitetet shërbejnë në SHPK. Statistikat jo vetëm që reflektojnë shumëlojshmërinë e popullatës – 16% nga komuniteti joshqiptar; por gjithashtu demonstron që femrat police mund të luajnë rol në zbatimin e ligjit gjatë mbrojtjes dhe shërbimit të shoqërisë – 15% të SHPK-së janë femra.

"Meqenëse trajnimet themelore të policisë kanë qenë prioritet yni, ne jemi fokusuar gjithnjë e më shumë në fushat e menaxhimit dhe aftësisë drejtuese, si dhe në kurset trajnuese të avancuara dhe të specializuara," tha Benet lidhur me kurset të cilat janë mbështetje e drejtpërdrejt për zhvillimin e plotë të SHPK-së në organizimin e mirë të shërbimit policor pasi që ata po marrin përsipër më shumë përgjegjësi.



Trajnimet e specializuara dhe njohuritë e fituara në SHSPK përfshijnë shkathtesitë për hetime të krimeve, mbikëqyrja, mjekësia ligjore, dhe luftimi i krimit të organizuar. Policët e SHPK-së gjithashtu janë trajnuar në teknikat moderne për t'u marrë me dhunën në familje, vetëdijësimin për trafikimin e njerëzve, dhe policinë në bashkëpunim me komunitete.

Gjatë procesit në fazë, trajnimi më i rëndësishëm dhe mbështetja teknike që funksionon në kuadër të SHPK-së iu është ofruar 100 policëve të cilët tash janë kthyer në shkollën policore si trajnues. Me gjithë reduktimin e madh, stafi ndërkombëtar vazhdon të ofrojë mbështetje të nevojshme për procesin e vazhdueshëm të ngritisë së kapaciteteve për një afat të gjatë. Kjo është dëshmuar me shumë sukses pasi që synon për qëndrueshmëri të institacioneve.

Gradualisht, SHSPK-ja është zhvilluar si një institut që paraqet një model të mirë për edukimin profesional dhe zhvillim të personelit për siguri publike. OSBE-ja gjatë këtyre viteve ka ofruar mjeshtëri të konsiderueshme speciale edhe në misionet tjera në RIJ të Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi, dhe Azerbejxhan.

Gjatë këtyre pesë viteve, shkolla ka ofruar shërbime për disa disciplina kryesore në sistemin për siguri publike – duke përfshirë shpëtimin nga zjarri, ndëshkimet, policia kufitare dhe dogana. Si dhe siguria e trupit gjyques. Stiv Benet beson që shkolla dhe SHPK-ja do të vazhdojnë të ekzistojnë në të ardhmen dhe do të punojnë për interesat e gjithë popullit të Kosovës. "Unë besoj që shkolla do të zhvillohet në atë çfarë kosovarët përcaktojnë se është zgjidhja më e mirë për zhvillim dhe edukim të sigurisë publike."

### Policia dhe Komuniteti

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) është i pranishëm te ne për vetëm 6 vjet, dhe kjo do të thotë që ky shërbim është ende duke u përpjekur që të ndërtojë besimin te njerëzit të cilëve iu shërben. Më shumë se besim, në Kosovë ka trashëgimi të mosbesimit dhe mungesë të bashkëpunimit. Në mes të policisë dhe popullit duhet të ndërtohet një lidhje e ngushtë. SHPK-ja punon për të demonstruar se është forcë profesionale dhe mund t'i kundërvëhet çështjeve me të cilat përballet shoqëria.

Si një masë për të ndihmuar ndërtimin e besimit, Shkolla e Shërbimit Policor (SHSPK) e udhëhequr nga OSBE-ja, në vitin 2003 në bashkëpunim të ngushtë me bashkëpunëtorët ndërkombëtarë dhe vendorë, zhvilloi Ekipet për Siguri të Komunitetit. Qëllimi i tyre është që të zhvillojnë marrëdhënie të reja dhe të përkrahin ato ekzistuese mes anëtarëve të komunitetit, përfaqësuesëve komunalë, dhe policisë.

Sipas konceptit të policisë, policiët dhe njerëzit e rëndomtë punojnë së bashku dhe zgjidhin problemet e komunitetit që kanë të bëjnë me krimin dhe parregullësinë shoqërore. "Esena e bashkëpunimit të policisë dhe komunitetit është që policia me anëtarët e komunitetit dhe përfaqësuesit e qeverisë t'ia arrijnë qëllimit të përbashkët për të zgjedhur krimin dhe shtuar sigurinë," tha Julie Fleming, koordinatore për Polici dhe komunitet në SHSPK.

Kultura e policisë e orientuar në të drejtë të njeriut synon të përforcojë tërë filozofinë e bashkëpunimit të policisë dhe komunitetit. Strategji e tyre ka dy rrugë kryesore për ndërrimin e metodave dhe praktikave të policisë për t'u bërë më demokratike, dhe për të krijuar marrëdhënie të forta bashkëpunuese mes policisë dhe opinionit publik.

Qytetarët shpeshherë mendojnë se siguria është tërësisht çështje e policisë. Julie Fleming mendon të kundërtën: "Të gjithë pjesëmarrësit vendorë duhet të angazohen për siguri të komunitetit. "Kjo lloj marrëdhënie i bënë njerëzit që ta kuptojnë pronësinë në vendosjen e prioriteve të policisë dhe si të ruhet komuniteti i tyre.

Ndërrimi i policisë tradicionale në policinë e komunitetit nuk është detyrë e lehtë.

Deri tash janë formuar ekipet prej 35 veta shumë veta janë duke u trajnuar në katër komunat që janë shtuar.

Ekipet për siguri të komuniteteve do të vazhdojnë të punojnë për të avancuar edhe më tepër filozofinë e policisë së komunitetit përmes implementimit të parandalimit, bashkëpjesëmarrjes, dhe strategjive të zgjidhjes së problemit për të adresuar problemet e njoftura nga policia dhe populli.

Një rezultat i dukshëm i kësaj përpjekje ka dalë përmes krijimit të një doracaku për siguri të komunitetit të quajtur: Vetëm Faktet – Informacion për Parandalimin e Krimit. Në rajonin e Prizrenit, Zyrtarët policorë të SHPK-së dhe palët kryesore të involvuar në komunë kanë punuar së bashku për të krijuar këtë libër, i cili ofron informata të nevojshme se si qytetarët mund të japin kontributin e tyre për të parandaluar krimin. Botimi i këtij doracaku është një shembull se si mund të shtohet bashkëpunimi duke involvuar edhe të tjerë përveç policisë në çështjet e zbatimit të ligjit me këtë rast krijon edhe kuptimin e pronësisë.

Sipas Ron Schwartz, menaxher në SHSHPK dhe specialist për siguri publike, është shtuar dukshëm komunikimi mes policisë, udhëheqësisë komunale dhe komuniteteve. "Që nga viti 2003, janë bërë projekte për zgjidhje të problemeve konkrete në komuna të ndryshme duke përfshirë të drejtuarit e rinisë dhe problemet e drogës në shkolla, çështjet e deponimit (gropojse), sigurimin e trafikut, qenët endacak, krimet në kufi, dhe shumë e shumë tjera," tha Schwartz.

Kjo është vetëm një nga shumë përfitime që vijnë nga policia e komunitetit, përveç që merren edhe me zvogëlimin e krimit dhe përmirësimin e sigurisë. Në të ardhmen pritet përparim më i madh për të punuar në mënyrë proaktive për zgjidhjen e problemeve të komunitetit.



*Parimi themelor i policisë së komunitetit është krijimi i partneritetit në mes të policisë dhe komuniteteve lokale, në veçanti me të rinjtë.*

## Mbrojtja e të drejtës për të protestuar në Kosovë

Zyrtarët policorë nga Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) tash janë më të aftë të përballen me trazirat civile, duke iu falenderuar trajnimit që është bërë në Shkollën e Shërbimit Policor të udhëhequr nga OSBE-ja.

Grupi i parë prej 70 policëve të SHPK-së ka mbaruar kursin në prill të vitit 2005, që ishte pjesë e përpjekjeve për të ngritur kapacitetet e policisë gjatë përballjes me situata të tensionuara siç ishin trazirat e marsit të vitit 2004, si dhe të sigurohet respekti për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut.



*Pas trazirave të marsit të vitit 2004, Shkolla Policore e Kosovës është angazhuar në një numër të trajnimeve përmenaxhimin e trazirave. Misioni i OSBE-së i përkrah këto përpjekje duke ofruar ekspertizë evropiane dhe praktika më të mira.*

Trajnimi i ofruar nga SHSHPK-ja është bazuar në taktitat daneze 'Mobilizimi i forcave' të cilat tash janë duke u miratuar nga një numër i vendeve të Evropës Perëndimore.

### Taktikat e reja policore

Menaxheri i Policisë Kombëtare Daneze, Kaspar Andreasen, i cili udhëhoqi ekipin prej katër trajnuesve dhe demonstrimin, shpjegoi: "Njerëzit kanë të drejtë të protestojnë dhe të shprehin opinionin e vet."

Sidoqoftë, ai e sheh detyrën e policisë në një situatë të tillë që të largojnë protestuesit e dhunshëm, të parandalojnë sulmin kundër të tjerëve dhe shkatërrimin e pronës, dhe t'u mundësojnë qytetarëve të shprehin mendimin. "Zyrtarët policorë duhet që të hapin dialog me përfaqësuesit e protestuesve dhe të pajtohen me mënyrën se si do të mbahet protesta," shtoi ai.

Filosofia kryesore e trajnimit ishte që policia në asnjë mënyrë të mos duket armiqësore ndaj turmës së demonstruesve. Policia – përderisa zbaton ligjin – nuk duhet të ekspozojë simbolet e forcës, siç janë shkopinjtë, mbrojtëset apo helmetat, kur përballet me parregullësitë publike.

Përballimi me trazira është një nga gjërat më të vështira me të cilat duhet të merret policia, pasi që policët mund të vihen në pozitë kur nuk kanë ndonjë zgjidhje tjetër përveç që të përdorin forcën kundër qytetarëve, për të cilët janë trajnuar që t'i mbrojnë dhe t'u shërbejnë.

Një nga trajnuesit, Agim Gërguri, toger në SHPK, komentoi: "Është vështirë të gjindesh në një situatë ku duhet të ballafaqohesh me popullin tënd. Por ne tash e dijmë këtë më mirë. Ne e dijmë se duhet të largojmë nxitësit e dhunës nga turma. Ne e dijmë se si të krijojmë komunikim me protestuesit dhe të bashkëpunojmë me ta."

## EDUKIMI DHE ZHVILLIMI I POLICISË

### Zhvillim i mëtutjeshëm i kapaciteteve policore

Duke i marrë parasysh mësimet nga trazirat e marsit të vitit 2004, Misioni i OSBE-së gjithashtu ka

kërkuar mënyra për zhvillim të mëtutjeshëm të kapaciteteve policore, ashtu që t'i u mundësojë atyre të marrin përsipër përgjegjësi të plotë dhe të përballen me situata të tilla.

Një nga problemet kryesore gjatë trazirave ishte mungesa e koordinimit në mes të SHPK-së, policëve civilë të UNMIK-ut dhe KFOR-it (forca ndërkombëtare e NATO-s, përgjegjëse për siguri në Kosovë), gjithashtu misioni është duke punuar të sigurojë këmbimin e informatave në mes të të gjitha palëve.

Ambasadori norvegjez për NATO, Kai Eide, i cili ishte ftuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së që të raportojë për trazirat, në rekomandimet e tij thotë se prioritet janë trajnimet i policisë dhe këmbimi i informatave.

Ndërsa KFOR-i dhe policia civile e UNMIK-ut ende luajnë rolin në mbajtjen e sigurisë në Kosovë, është me rëndësi që policia e Kosovës ka aftësi që të veprojë e pavarur.

"Ne dëshirojmë ta dijmë për çka është e aftë SHPK-ja, kështu që ata e dijnë çfarë të presin dhe mund të planifikojnë si të mbështesin veprimet sipas rrethanave," tha Heinz Schneider, nga OSBE-ja, trajnues ndërkombëtar i policisë në SHSPK.

### Dialog me protestuesit

Pas protestave në Danimarkë, njoftoi menaxheri Andreasen, policia ftoi liderët e protestës për të diskutuar lidhur me atë se çka shkoi, dhe çka nuk shkoi mirë.

Togeri Gërguri shtoi se njësia tjetër ishte duke punuar për policinë e komunitetit dhe parandalimin e konfliktit. Me këto dy njësi që bashkëpunojnë për të zhvilluar dialog me protestuesë, mundësitet që protestat apo trazirat të kenë pasoja negative do të zvogëlohen në masë të madhe.

15 trajnuesit më të mirë, të cilët tash janë kualifikuar si trajnues, do të bartin diturinë e tyre tek 500 policë të cilët do të formojnë ekipe të SHPK-së për çregullime publike për t'u marrë me situata të tilla. Trajnimet të cilat do t'i ofrojnë gjatë vitit 2005 do të mbahen në bashkëpunim me SHPK-në dhe njësitë për mbështetje rajonale të SHPK-së, të krijuara për të asistuar punën trajnuese.

### Është realitet – femrat bëjnë ndryshime

Involvimi i femrave në Shërbimin Policor të Kosovës ka qenë një nga sfidat më të mëdha të Departamentit për Zhvillim dhe Edukim të Policisë në Misionin e OSBE-së më të cilat ky Departament është ballafaquar që nga fillimi në shtator të vitit 1999.

Duke marrë parasyshë mentalitetin patriarkal që ende është i pranishëm në Ballkan, nuk është pritur që femrat do të interesoheshin që të marrin pjesë në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Mirëpo në realitet interesimi ishte mjaft i madh.

### Femrat police të SHPK-së mund të punojnë njësoj mirë si kolegët e tyre meshkuj

Femra në Kosovë, si në çdo vend tjetër në botën perëndimore, tregoi se nuk ka rolo përgjegjësi në shoqëri që ajo nuk mund ta marrë përsipër. Faktikisht, përvaja në Kosovë na mësoi se policet e SHPK-së mund të jenë të mira, nëse jo edhe më të mira, se kolegët e tyre meshkuj, në kryerjen e të gjitha detyrave.

Është inkurajuese se të gjitha kadetet e SHPK-së dhe policet e diplomuara kohët e fundit ishin mbështetur fuqimisht nga familja e tyre, kolegët, shokët dhe shoqëria. Menjëherë pas vitit 1999, të shohësh police femër në rruget e Kosovës, për shumë veta ishte si një ënderr që u bë realitet.

"Familja ime mburret me mua që u bëra police dhe kam rast t'i shërbejë popullit të Kosovës. Jam shumë e lumtur që kam mundësi të dëshmoj se femra kosovare mund të bëjë ndryshim shumë të madh në përmirësimin e jetës së gjithë kosovarëve," thotë Arbresha Bajrami e cila shërben në stacionin policor rajonal në Pejë, dhe është shpërblyer nga SHPK-ja me medale të parë për shpëtim të jetës.

### Të gjithë shërbejnë nën një flamur

SHPK-ja është shumë krenare për përbërjen e vet shumëetniqe. Duke iu falenderuar përpjekjeve të pafundme dhe kontributin e OSBE-së dhe komunitetit ndërkombëtar, sot ne kemi femra dhe meshkuj nga të gjitha grupet etnike që shërbejnë nën një flamur, flamurin e Shërbimit Policor të Kosovës.

Slagjana Stojanovic, Instruktore në SHPK dhe nënë e dy fëmijëve, tha: "Jam shumë e kënaqur që kam rast të tregojë që femrat mund të bëjnë punë të vështira dhe me përgjegjësi në Kosovë dhe mund të bëjnë ndryshime pozitive."

Ne mund të themi se OSBE-ja ka plotësuar mandatin në këtë çështje. Nga 7000 policë të cilët kanë diplomuar në programin për zhvillim dhe edukim në SHPK, 15 përqind janë femra që përfaqësojnë të gjitha grupet etnike të Kosovës.

Që nga titori i vitit 1999, kur klasa e parë me 176 anëtarë të ri ka diplomuar në SHPK, policet kosovare ishin të pranishme në se cilës klasë. Klasa e 31 me radhë është paraparë që të mbarojë programin e edukimit themelor më 16 dhjetor 2005, në të cilën SHPK-ja do të ketë përbërje etnike dhe gjinore si vijon:

Shqiptarë	83.5%
Serb	10.5%
Tjerë:	6% Kosovo Roma, Turks, Gorani, Bosniaks, and Muslim Slavs
Meshkuj	85%
Femra	15%



Policet femra të SHPK-së mund të jetë të mira në punën e tyre sa edhe kolegët e tyre meshkuj.

## QEVERISJA E MIRË

Për të themeluar një qeverisje të mirë e cila përkrah parimet e sinqeritetit ndaj nevojave të qytetarëve dhe llogaridhëni, së pari duhet të krijohen institucione qeveritare të efektshme në të gjitha nivelet administrative.

Pas themelimit të administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1999, organet vendore qeveritare të Kosovës ishte dashur të ndërtohen duke filluar nga zero. Organi i vetëm vendor që funksiononte në atë kohë ishte Qeveria e vetëemëruar e përkohshme e Kosovës.

Misioni i OSBE-së ishte përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve dhe ndërtimin e institucioneve, e gjithashtu kishte rolin kyç në themelin e institucioneve të reja vetëqeverisëse. Zgjedhjet e para komunale janë mbajtur në vjeshtë të vitit 2000 ndërsa zgjedhjet e para për Kuvendin e Kosovës në nëntor të vitit 2001.

Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), organet më të reja të zgjedhura në mënyrë demokratike në Evropë, duhej që të njoftoheshin me detyrat e veta dhe të zhvillojnë strukturat dhe rregulloren e punës së Kuvendit. Ata, gjithashtu, duhej që të njoftoheshin dhe të z...

Duke ofruar asistencë në të gjitha fushat, Misioni i OSBE-së punon me qëllim të sjelljes së institucioneve deri në nivel të pajtueshëm me shoqërinë e zhvilluar evropiane, dhe të sigurojë që qytetarët janë përfshirë në proceset vendimmarrëse. OSBE-ja monitoron punën e IPVQ-së, duke ofruar këshilla dhe trajnime për të ndihmuar që të ngrisin kapacitetet për t'i shërbyer më mirë opinionit publik.

Asistanca për Kuvendin e Kosovës përfshin ofrimin e njojurive teknike dhe përkrahje, duke zhvilluar rregulloren e punës së Kuvendit, duke bërë zhvillimin e potencialit legjislativ, koordinimin e asistencës së donatorëve dhe mbështetjen e drejtë të sigurimit që të gjitha dokumentet dhe legislacioni i Kuvendit të janë në përputhje me përkthimin në gjuhët zyrtare (përveç gjuhëve vendore, kërkohet edhe versioni në gjuhën angleze).

Qeveria mbështetet përmes këshilltarëve të caktuar në Zyren e Kryeministrat, përmes të cilëve ofrohet asistencë në implementimin e standardeve për Kosovën. Misioni, gjithashtu, punon me qeveritë komunale, duke ngritur kapacitetet e ekzekutivit dhe degëve legislative me ofrimin e trajnimeve profesionale dhe duke ndihmuar formimin e komisioneve mandatore dhe jomandatore, që të bëjë punën e tyre më të efektshme.

Me qëllim që të sigurojë zhvillim profesional të vetëqëndrueshëm të shërbyesve publikë, Misioni i OSBE-së, gjithashtu, ka ndihmuar që të krijohet Instituti për Administratë Publike që tash është bërë organ i pavarur dhe vazhdon të gjëzojë mbështetjen e OSBE-së.



Reagimi ndaj nevojave të qytetarëve është esenca e qeverisjes së mirë.

### Iniciativa për Mbështetjen e Kuvendit – IMK

Pas zgjedhjeve të para parlamentare në nivel të Kosovës në nëntor të vitit 2001, Kuvendi i Kosovës e filloj punën e tij si parlamenti më i ri demokratik në Evropë. Duke qenë një institucion i ri, ai ka pasur nevojë të themelojë strukturat e veta, të njoftohet me parimet themelore të një sistemi demokratik parlamentar dhe të fillojë të funksionojë sipas këtyre parimeve. Misioni i OSBE-së, Shtylla për ndërtimin e institucioneve e administratës së përkohshme ndërkontëtare të KB-së, ishte aty për të ndihmuar.

Një grup bilateral dhe multilateral i donatorëve – dhjetë organizata partnere evropiane, amerikane si dhe ato anëtare të KB-së – janë

mbledhur në Misionin e OSBE-së, të nxitur nga Iniciativa për Mbështetjen e Kuvendit (IMK), për të ofruar dhe bashkërenduar mbështetje të gjerë për Kuvendin.

“Duke iu falenderuar IMK-së, janë tejkualuar shumë vështirësi të fazës fillestare,” pohoi Dr. Friedhelm Frischenschlager, i cili ka shërbyer si Drejtor i departamentit për demokratizim të Misionit të OSBE-së prej shtatorit 2002 deri në mars 2004. Zbatimi i shtuar i procedurave dhe proceset e krijuara e kanë zëvendësuar gradualisht ad-hoc-izmin dhe improvizimin në punën e Kuvendit.

Gjatë katër viteve të kaluara, Misioni i OSBE-së ka punuar me të gjithë strukturat e Kuvendit (kryesinë, grupet parlamentare, komisionet dhe sekretariatin) për të arritur efikasitet dhe zbatim më të madh të Rregullores për punën e Kuvendit dhe të praktikave demokratike, dhe për të përmirësuar aftësitë ligjvënëse. I ka kushtuar vëmendje të posaçme krijimit të mundësive për të gjithë deputetët që në mënyrë aktive të marrin pjesë në punimet e Kuvendit dhe t'i përfaqësojnë interesat e bashkësive të tyre.

Sipas Franklin De Vrieze, udhëheqës i Ekipit të Misionit të OSBE-së për Mbështetjen e Qeverisë Qendrore dhe koordinator i IMK-së, puna e OSBE-së me Kuvendin qendron në monitorim dhe këshillim, por edhe në implementim të programeve për ngritjen e kapaciteteve, siç janë trajnimet, seminaret dhe vizitat kërkimore, dhe projektet e ndihmës teknike. Këto aktivitete shërbejnë përritjen e profesionalizmit të deputetëve dhe stafit të Kuvendit. Rezultati përfundimtar do të ishte përmirësimi i transparencës dhe promovimi i përfshirjes së shoqërisë civile në punën parlamentare.



Kuvendi i Kosovës është parlamenti më i ri demokratik në Evropë.

## QEVERTISJA E MIRË

Me mbështetjen e IMK-së, Kuvendi i parë i Kosovës u bë një institucion, i cili edhe përkundër pengesave objektive ia doli të tregojë progres dhe të arritura

në tri vitet e tij të punës, siç është miratimi i një numri të madh të ligjeve, ushtrimi i nismave ligjvënëse, organizimi i dëgjimeve publike për projektiljet, dhe përpilimi i raporteve të komisioneve në fund të mandatit të tyre.

Në tetor të vitit 2004 janë mbajtur zgjedhjet e dyta parlamentare. Partnerët e IKM-së i vazhduan përpjekjet e tyre dhe tani punojnë për ta përforcuar më tepër Kuvendit e zgjedhur dhe për ta përmirësuar funksionimin e tij.

“Menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 2004, një program gjithëpërfshirës orientues është mbajtur për deputetët e rinj të Kuvendit, ndërsa një program tjeter mbështetës është mbajtur edhe për deputetët edhe për stafin,” pohoi z. De Vrieze. Për t’ë evituar një periudhë të gjatë stagnimi, gjë e cila ka ndodhur me rastin e themelimit të Kuvendit në mandatin e parë, Misioni i OSBE-së e ka ndihmuar Kuvendit e ri në vendosjen e strukturave të tij dhe në të qenurit funksional në kohë të arsyeshme. “Misioni i OSBE-së i ka ofruar ndihmë edhe sekretariatit të Kuvendit për t’i përbushur përgjegjësitë e tij pas zgjedhore dhe për t’ia dorëzuar me sukses detyrat Kuvendit të ardhshëm,” shtoi z. De Vrieze.

Për të ndihmuar në adresimin e sfidave të krijuara nga kërkosha ligjore për përdorimin e dy gjuhëve zyrtare, gjuhës shqipe dhe serbe, dhe për të ndihmuar në zbatimin e akteve ligjore të nxjerrura dhe të shpallura nga administrata ndërkombëtare, OSBE-ja në vitin 2005

e ka publikuar një fjalor në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht) të shprehjeve parlamentare dhe ligjore. Fjalori gjithashtu ndihmon në përvetësimin e ndihmës ligjore ndërkombëtare lidhur me hartimin e ligjeve, e cila zakonisht jepet në gjuhën angleze.

Në qershor të vitit 2005, OSBE-ja e ka ndihmuar gjithashtu Kuvendin në organizimin e ngjarjes së parë rajonale ndërparlamentare në Prishtinë, e cila është përqendruar në kontrollin parlamentar të punës së Qeverisë. Z. Peter Vanhoutte, ish-deputet i Kuvendit të Belgjikës dhe i cili tani në emër të OSBE-së këshillon Kryetarin e Kuvendit, tha që kjo ngjarje ishte historike. Shpresojmë që ky është fillimi i proceseve dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet organeve të zgjedhura qeveritare, të cilët do të ndihmojnë në zhvillimin e rajonit.

Sidoqoftë, disa vështirësi institucionale kanë mbetur. Edhe pse kishte përmirësim në lëmitë, siç është përpilimi i rendit të ditës, votimi, shpërndarja e dokumenteve, interpretimi dhe përkthimi i dokumenteve, ende kishte mungesë në menaxhimin transparent të sekretariatit të Kuvendit dhe mungesë tipike të cilësisë së përkthimeve ligjore në IPVQ-të. Ekspertët dhe procedurat e institucionalizuara për vendosjen dhe mbajtjen e kontakteve ndërparlamentare ende mungojnë. Prandaj, mbështetja e vazhduar ndërkombëtare mbetet vendimtare për tejkalimin e sfidave politike, procedurale dhe administrative, të cilat gjinden para Kuvendit.

Për të pasqyruar sfidat dhe përparimet, si dhe llojet e ndryshme të ndihmës që i ofrohen Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë, Misioni i OSBE-së publikon Buletinin e IMK-së. I shtypur në katër gjuhë – shqip, serbisht, turqisht dhe anglisht – ai shpërndahet në tërë Kosovën dhe u përcillet në mënyrë elektronike një grupi marrësish në nivel botëror që nga koriku i vitit 2002.

## Nga trajnimet e OSBE-së deri në Institutin e Kosovës për Administratën Publike

Këshilli i Përhershëm i OSBE-së në vendimin e vet 305, në korrik të vitit 1999, i ka dhënë për detyrë misionit të OSBE-së që të merret me edukimin e shërbyesve civilë në Kosovë.

Si institucione të reja vetëqeverisësë të sapothemeluara që janë dhe meqë shumë nga stafi ka pasur vetëm pak apo aspak përvojë në administratë, trajnimi i tyre ka qenë i domosdoshëm. Administrata civile funksionale ishte kuptuar si kusht paraprak për zhvillimin e institucioneve demokratike dhe realizim të të drejtave të njeriut.

“Në vitin 2000 Misioni ka krijuar Institutin e Administratës Civile dhe ky ka iniciuar mbajtjen e trajnimeve themelore për të punësuarit në komuna dhe qeveri qendrore,” tha Katja Salsbäk, zyrtare për administratë publike në mision.

Si rezultat, Institut i udhëhequr nga OSBE-ja ka zvogëluar angazhimin e vet. Në gusht të vitit 2003, u themelua Institut i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) si Agjension Ekzekutiv i Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe që nga atëherë funksionon dhe udhëhiqet nga shefi i ekzekutivit Naim Rrustemi.

Në ditët e para të ekzistimit të IKAP-it, OSBE-ja ka përkrahur atë intensivisht. Pasi që stafi ka qenë i ri, ata kanë pasur nevojë për zhvillim të ekspertizës, në mënyrë që të mund të ofrojnë trajnime, planifikim dhe kurse për zhvillim profesional. Ekspertët e OSBE-së kanë punuar në bashkëpunim të ngushtë me shefin e ekzekutivit për të hartuar një vizion dhe programe strategjike të institutit. “Trajnuesit tanë kanë punuar me stafin e IKAP-it në fushat përkatëse të përgjegjësive,” tha Salsbäck.

Përmes një konference ndërkombëtare mbi Administratën publike, IKAP ka krijuar kontakte rajonale dhe ka qenë në gjendje të këmbejë dhe përvetësojë njohuri. Me ndihmë të OSBE-së ata gjithashtu kanë formuar një bibliotekë të pasur të literaturës për administratë publike me ilustrime ndërkombëtare të kohës së fundit.

Sot, IAPP është një Agjencion Ekzekutiv dinamik i Ministrisë së Shërbimeve Publike. Studimi i Komisionit Evropian ka treguar që IKAP ishte një nga dy qendrat e trajnimit për shërbime civile në Ballkan me një menaxhim të themeluar mirë që punon me planin strategjik afatgjatë.

Në kohën e vitit të parë, seancat trajnuese të ofruara nga IKAP-i ishin ndjekur nga 2,800 pjesëmarrës nga sektori i administratës civile, pastaj numri ishte rritur gjatë vitit 2004 dhe 2005. Në vitin 2006, IKAP-i do të zgjerojë aktivitetin trajnues për shërbimesit civil që u takojnë grupeve etnike të minoritetit dhe do të synojë që më shumë të përmirësojë cilësinë e trajnimeve dhe përforcojë rrjetin e vet të resurseve njerëzore. Misioni i OSBE-së do të vazhdojë të mbështesë IKAP-in me punën e vet në dy mënyra, edhe materialisht edhe me këshilla.



Nëpunësit civilë profesionalë dhe të mirëinformuar, sigurojnë efikasitet të qeverive lokale dhe asaj qendrore. Institut Kosovar për Administratë Publike është duke ndihmuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre.

## Fillimet e qeverisjes komunale

Para mbajtjes së zgjedhjeve të para demokratike komunale të organizuara në tetor të vitit 2000, Misioni i OSBE-së kryesish ka monitoruar punën e institucioneve të vetëemëruara, të ashtuquajtura "Qeveria e Përkoshme e Kosovës". Intervenimet e para ishin të pakta pasi që këto institucionë ishin të vetëemëruara dhe nuk ishin përfaqësuese në mënyrë demokratike.

Qeveria në nivelin komunal nuk është një koncept i ri në Kosovë. Mirëpo, zgjedhjet komunale të vitit 2000 ishin fillimi i epokës së re në shumë komuna. Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisje të Komunave në Kosovë, bazuar në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, iu ka dhënë komunave një hapësirë të madhe të përgjegjësive, kështu që, roli i Misionit të OSBE-së, Shtylla për Ndërtimin e Institucioneve, ishte të asistojë Kuvendet Komunale të sapozgjedhur në përbushjen e përgjegjësive.

"Pas zgjedhjeve të para komunale, Misioni ka filluar një program trajnues të quajtur Kuvendi Komunal pas zgjedhjeve," tha Hartmut Purner, zëvendësreitor në Departamentin e Demokratizimit të Misionit të OSBE-së. Programi është mbajtur në shumicën e komunave, dhe ka synuar në ngritjen kapaciteteve të anëtarëve të sapozgjedhur të Kuvendit në kryerjen e përgjegjësive të tyre, pasi që shumica e afër 9000 anëtarëve të kuvendeve asnjëherë më parë nuk kishin qenë zyrtarë të zgjedhur në poste.

Sidoqoftë, pas zgjedhjeve të dyta në vitin 2002, një program trajnimi më shumë gjithëpërfshirës i njohur si Pajisje Fillestare për Kuvendin Komunal (PFKK), ishte përpiluar për të ngritur përvojën e fituar tashmë të pranishme në Komuna. Sipas Purnerit, programi ka inkurajuar një organ ligjëvënës më shumë përfaqësues dhe efektiv. Anëtarët vendorë të Misionit ishin paraqitesit kryesorë të PFKK-ut. "Kjo lejoi një ndërveprim të drejtëpërdrejtë më të afërt në mes të trajnuesve dhe pjesëmarrësve në trajnim," shtoi ai.

Trajnimi ishte përgatitur që të njoftojë anëtarët me ligjin e aplikueshëm dhe parimet demokratike në të cilin bazohet si dhe të asisitojë atë në implementimin e ligjit. "Në këtë mënyrë ne mund të diskutojmë haptas për disa çështje kyçë, siç është ndarja e pushteteve, politizimi i shërbimit civil, qasja në informata, dhe roli i opozitës," tha Arian Dragaçina, asistent i zyrtarit për demokratizim në Mision.

Gjatë periudhës së nëntorit të vitit 2002 deri në qershori të vitit 2003, gjithsej 1,931 pjesëmarrës nga të gjitha komunat dhe të gjitha komunitetet e tyre kanë marrë pjesë në PFKK. Efekti i plotë i trajnimit ende është duke u vlerësuar. "Shumë Kuvende Komunale që atëherë kanë treguar respekt më të madh për rregulla dhe procedura, dhe ata janë të udhëhequr me më shumë efikasitet," tha Dragaçina. Sipas tij, kuvendet gjithashtu demonstrojnë ndërrime drejt marrëdhënieve konstruktive mes pozitës dhe partive në opozitë dhe si rezultat gjëzojnë më shumë debate frytdhënëse.

OSBE-ja ka zhvilluar më tutje konceptin e PFKK-ut dhe ka implementuar një program trajnimi pasues, duke mbuluar çështjet që

kanë të bëjnë me politika, siç është ajo e komisionit komunal dhe proceset e buxhetit.

Aktualisht, Misioni zhvillon më tepër iniciativën e vet për ngritje të kapaciteteve që janë specifike për nevojën e regjioneve ose komunave.

Paralelisht me ngritjen e kapaciteteve Misioni i OSBE-së gjithashtu është duke luajtur një rol aktiv në procesin e transferimit të kompetencave nga niveli qendror i qeverisë në atë komunal. Ky proces shpeshherë referohet si "decentralizim", ose më saktësisht, reformë e qeverisjes lokale.

Fillimisht, në nëntor të vitit 2003, Misioni ka organizuar një konferencë, ku për herë të parë ka diskutuar për konceptin e decentralizimit me të gjithë akterët e IPVQ-së dhe UNMIK-ut. Gjithashtu ka punuar në Grupet Punuese të përziera vendore-ndërkombëtare që kanë përpiluar Dokumentin e Kornizës në vitin 2004 për Reformën e Qeverisjes Lokale. Kur Ministria e Administratës për Qeverisje Lokale është krijuar për të mbështetur procesin e decentralizimit Misioni ka mbështetur aktivitetet e veta, në veçanti duke drejtuar seancat për ngritjen e kapaciteteve për Kuvendet e Përkohshme në Njësitë Pilote Komunale (KPN).

NjPK-të tash janë duke u përdorur që të testohet funksionimi i komunave që në të ardhmen do të mbajnë më shumë kompetencia në fushën e edukimit, shëndetësisë, dhe infrastrukturës, dhe që të jenë përgjegjëse e të sigurojnë qëndrueshmërinë e vet financiare. Pilot Njësità Komunale, gjithashtu, janë shfrytëzuar për të testuar ndryshimet e mundshme në riorganizimin territorial të komunave të Kosovës. Misioni mbetet i involvuar që të sigurojë ngritjen e kapaciteteve adekuate lokale për të kryer procesin.



*Ofrimi i shërbimeve në mënyrë efektive dhe të shpejtë duhet të jetë qëllimi i se cilës administratë. Komuna e Malishevës ka krijuar një sportel ku qytetarët mund të shërbehen.*

## Zhvillimi lokal

Në vjeshtën e vitit 2004 Misioni i OSBE-së, në bashkëpunim me Agjencionin për Ndërmarrje Rajonale me bazë në Kosovë, filloi implementimin e një projekti ambicioz të quajtur Buxheti Pjesëmarrës dhe Menaxhimi i Financave Publike. Projekti synonte ngritjen e kapacitetetve të gjashtë Komisioneve Komunale për Financa dhe Politikë, në rajonin e Prishtinës.

Projekti kujdeset për asisitencë teknike dhe për trajnime. Ai thekson nevojën për të paraqitur procese vendimmarrëse transparente dhe efektive që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve. "Qëllimi i projektit ishte të asistojë komunat në menaxhimin e sfidave të modernizimit dhe zhvillimit të shpejtë rajonal," tha Michael Walker, udhëheqës i ekspit për demokratizim në zyrën e OSBE-së në Prishtinë.

Modulet e trajnimit janë përpiluar dhe janë mbajtur nga shtatori deri në nëntor të vitit 2004. Ata kanë adresuar sfidat e se cilës komunë në veç

Pastaj, pas një kohe të shkurtë ka pasuar një tryezë të rumbullakët me temën "Policia dhe Prioritetet." Kjo iu ka lejuar pjesëmarrësve që të përkrahin investimet komunale dhe projektet nga të cilat besojnë se do të mësojnë komunat tjera – siç është projekti Parku i Paqës në Podujevë dhe Inkubatori i Biznesit në Shtime. Tryeza e rrumbullakët u shndërrua në një bazë dhe ushtrim për ngritje të ekspit për një afrim më të madh kolektiv për qeverisje rajonale.

## QEVERTISJA E MIRË

lehtë dhe të kuptueshme,” tha Walker. “Brosura gjithashtu ka përkrahur rëndësinë e pagesës së tatimeve.”

Zyrtarët Komunalë për Informim ishin të angazhuar për përpilimin, shkrimin dhe shpërndarjen e broshurës. Shumë prej tyre për herë të parë kishin mbajtur një fushatë të tillë.

Ishte inkurajuese të shikosh gjithë atë entuziazëm dhe përkushtim të demonstruar nga pjesëmarrësit gjatë tërë fazave të projektit. Udhëheqësi i ekspitit të grupit të PDK-së për Prishtinë ka falenderuar OSBE-në për punën e bërë dhe tha: “Ne anëtarët e Komisionit për Financa dhe Politikë kemi përvojë në profesionet tona por me të vërtetë kemi pasur nevojë për një trajnim të këtillë në mënyrë që të kuptojmë dhe vlerësojmë raportet që i marrim nga zyrtarët”.

Shpresohet se kontaktet dhe besimi i fituar përmes këtyre trajnimeve do të ndihmojë të hapet rruga për punën e ardhshme të Misionit të OSBE-së në monitorimin dhe ngritjen e kapaciteteve në të gjitha komunat e Kosovës.

### Duke dëgjuar qytetarët

Interesat dhe nevojat e të gjitha komuniteteve dhe qytetarëve të Kosovës duhet të përfaqësohen në mënyrë të plotë dhe të drejtë në të gjitha degët e qeverisë dhe të institucioneve.

Për të përkrahur këtë parim, Misioni i OSBE-së ka organizuar një seri udhëtimesh përfaqësuesit e lartë (anëtarët e Kuvendit, shërbyesit e lartë civilë, zyrtarët e UNMIK-ut dhe mediat), të administratës së komunave të Ferizajit, Kaçanikut dhe Shtërpcës.

“Vizita e tyre kishte për qëllim t’iu jipet rast politikanëve vendorë që të shohin standardin e jetesës, në radhë të parë, dhe gjithashtu t’u jipet mundësia qytetarëve që t’i shprehin drejtësirat problemet e veta ndaj udhëheqësisë vendore,” tha Marc Kalmbach, zyrtar për demokratizim në zyrën e OSBE-së në Shtërpcë. Gjendja socio-ekonomike, shërbimet komunale të ofruara për qytetarët, infrastruktura e rrugëve dhe punësimi, ishin çështjet kryesore që u diskutuan. Vizitat kryesisht ishin bërë për komunitetet që jetojnë në largësi dhe në pozitë jo të favorshme në secilën nga tri komunat.

Vizita në Ferizaj, në mënyrë specifike ka përfshirë rajonin e të kthyerëve në Bablak. Sipas Marc Kalmbach, udhëheqësia komunale për herë të parë ishte ballafaquar me çështjet që i shqetësojnë serbët e Kosovës, si dhe opinionet e komunitetit shqiptar se si i pranojnë ata.

“Vizitat dhe takimet me qytetarët vendorë ishin përcjellur mirë dhe vlerësuar lart,” tha Mohamed Sagdati asistent për demokratizim, i cili gjithashtu punon në zyrën e OSBE-së në Shtërpcë. Gjatë diskutimeve dhe gjatë vizitatve, fshatarët nuk kishin nguruar të ngrisin zërin për problemet, ankesat dhe zemërimin. “Ata treguan, megjithatë, një mirëkuptim për kufizi-

“Komponenti përfundimtar i projektit ka përfshirë krjin e një broshure për informim publik të përpiluar për të spjeguar shpenzimet komunale në mënyrë të



*Projekti për Menaxhimin e Financave Publike dhe Buxhetit me Participim ka për qëllim të përmirësojë kapacitetet e komisioneve për politikë dhe financa të gjashë komunave, përmes trajnimeve dhe ndihmës teknike.*

met e parashtruara nga buxheti i pamjaftueshëm i komunës,” shtoi Sagdati.

Politikanët si dhe opinioni publik në përgjithësi janë pajtuar që ngjarjet të këtilla të organizohen rregullisht nga zyrtarët komunal. Si rezultat i tërë këtyre vizitave janë implementuar ose janë në përgatitje një numër projekteve për infrastrukturë, siç është zhvillimi i sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Përvojat për Ferizaj, Kaçanik dhe Shtërpçë duhet të inkurajojnë administratat tjera komunale që të ndjekin të njëjtin shembull dhe t’iu shërbejnë më mirë qytetarëve të tyre.



*Misioni i OSBE-së përkrah organet komunale në themelimin e bashkëpunimit të mirë me opinionin publik.*

## ZHVILLIMI DHE PËRKRAHJA E MEDIAVE

Kryesisht kanë shikuar kanale satelitore dhe transmetuesit televizivë nga Shqipëria. Informatat që ofrohen nga këto kanale televizive dhe qasja në to nuk ishte e mjaftueshme.

Në atë kohë, u vendos administrata civile, komunitete të tëra kthesin në vendin e tyre të origjinës, struktura të reja politike dhe ekonome si dhe policore e gjyqësore, ishin në proces të krijuar. Hapja e kanaleve të komunikimit masiv dhe plotësimi i nevojave për informim ishin të një rëndësia të veçantë për administratorët ndërkombetarë.

Themelimi i transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës (RTK) në shtator të vitit 1999 ishte një ndër masat e para që OSBE-ja ndërmori si pjesë e rolit të saj si Shtylla për ndërtimin e institucioneve të Administratës së Përkohshme të KB-së. Për të ndihmuar në rregullimin e sektorit të mediave, Misioni, po ashtu, ka themeluar institucionin e Komisionerit të Përkohshëm për Media (KPM) në qershor të vitit 2000.

Gjatë zhvillimit në vitet e fundit me përkrahje të Misionit, RTK-ja është bërë mediumi të cilit publiku i beson më së shumti. Përveç themelimit të RTK-së dhe sigurimit se RTK-ja ofron informacione dhe program në gjuhët e folura nga grupe të ndryshme etnike, Misioni i OSBE-së ka përkrahur edhe zhvillimin e disa mediave private në mbarë Kosovën. Misioni ka marrë edhe rolin e monitoruesit dhe këshilluesit, duke ofruar trajnime sipas nevojës.

Sidoqoftë, raportimi joprofesional nga shumica e mediave, duke përfshirë RTK-në, për ngjarjet rreth mbytjes në ujë të tre fëmijëve shqiptarë në mars të vitit 2004, ka nxitur trazira në të cilat 12 njerëz janë vrapë dhe 2,000 janë detyruar të lëshojnë shtëpitë e tyre.

Është e qartë se trajnimet përgjegjshëm që i ka ofruar Misioni që nga viti 1999 nuk kanë mjaftuar përsëri ta sjellë skenën mediale të Kosovës në nivel evropian.

Duke ndryshuar qasjen e saj, OSBE-ja ka emëruar një këshilltar ndërkombetar përsëri çështje informative në RTK përsëri të ndihmuar përmirësimin e politikës redaktuese të RTK-së. Komisioneri i Përkohshëm përsëri Media është detyruar të gjobisë tre transmetuesit që mbulojnë tërë territorin e Kosovës (RTK-në, Kohavizioni dhe RTV 21). RTK-ja është dashur të zotohet të jap 100,000 euro përsëri trajnim të gazetarëve dhe redaktorëve. Këto trajnime kanë filluar të rengjohën rezultatet e para pozitive në punën e transmetuesit.

Në verën e vitit 1999, Kosova është karakterizuar me mungesë gati të tërësishtë të mediave. Vetëm disa radiostacione kanë funksionale. Njerëzit



Misioni i OSBE-së ka ndihmuar themelimin e RTK-së, transmetuesit të vetëm publik në Kosovë.

Duke shikuar situatën aktuale të mediave, problemi më i madh duket të jetë se shumica e këtyre mjeteve të informimit vështirë mund të definohen si 'media.' Ato funksionojnë kryesisht si makineri përzbatje, duke reklamuar batanije elektrike dhe duke lëshuar muzikë folk. Kështu, puna e Misionit këto ditë përqendrohet në përkrahjen e shtypit të përgjegjshëm dhe në identifikimin dhe përkrahjen e transmetuesve që kanë gjasa të mira përsëri të ardhmen, gazetarë dhe projekte mediale të cilat iu ofrojnë qytetarëve të Kosovës informata të cilësisë së lartë përsëri të gjitha komunitetet.

Qëllimi i përgjithshëm është të përkrahet shkollimi profesional i stafit redaktues dhe sigurimi se të gjithë qytetarët kanë qasje në informata relevante në mënyrë që të gjithë mund të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse dhe proceset demokratike.

Një fushë tjetër ku përqendrohet Misioni do të jetë monitorimi i mediave përsëri shikuar nëse ato zbatojnë kodet e reja të mirësjelljes të aprovara përsëri media të shtypura dhe elektronike dhe do të jap këshilla përmirësimet e nevojshme. Po ashtu, do të ndihmojë punën e Komisionit të Pavarur përsëri Media (KPM), i cili është themeluar si pasardhës i Zyrës së Komisionerit të Përkohshëm përsëri Media. Ligji përsëri Komisionin e Pavarur përsëri Media (KPM) ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2005.



Këshilli i Mediave të Shkruara, organ vetëregullues i mediave të shkruara, i themeluar kohëve të fundit, po merr çdo ditë e më shumë rolin e monitoruesit të asaj se sa e respektojnë gazetarët Kodit e Mirësjelljes.

## ZHVILLIMI DHE PËRKRAHJA E MEDIAVE

v

Në shtator të vitit 2004, fshati Gorezhdevc, ku mund të hyhet vetëm pas kalimit të pikë-kontrollit rigoroz të KFOR-it, u bë edhe njëherë vend ku ndodhi diçka - kësaj radhe e këndshme - që tërroqi vemendjen e Kosovës. Radiostacioni afër bukëpjekësit transmetoi edicion informativ në nivel të Kosovës në gjuhën serbe. Për herë të parë pas konfliktit, popullata serbe e Kosovës dëgjonte program lajmesh mbarërajonal, të transmetuar nga më shumë se 20 radiostacione tjera serbe në mbarë Kosovën.



Radioja mbetet akoma burim kryesor i informatave për shumë komunitete të Kosovës.

Agjencioni Evropian për Rindërtim ka siguruar fondet për këtë projekt, kurse Misioni i OSBE-së në Kosovë është zgjedhur partner implementues. Projekti nuk arriti të implementohet për zgjedhjet e vitit 2001 por është përgatitur në kohë për zgjedhjet e dyta parlamentare në vjeshtën e vitit 2004.

Janë dashur më shumë se tri vjet për ta filluar projektin që ka kushtuar më shumë se një çerek milioni euro. Reagimi filletar i dëgjuesve ka treguar se ka pasur nevojë për një gjë të tillë shumë më herët.

Stafi i OSBE-së ka përcjellë dy javët e para të transmetimit duke siguruar trajnim në radiostacione. Derisa në Gorazhdevc nuk ishim në gjendje të dëgjonim programin në radiostacion pasi që nuk kishte studio inçizuese të ndarë dhe kështu kishte akustikë negative, bukëpjekësi na ftoi në dyqanin e tij. Për të, ne ishim kalimtarë të rastit. "A keni dëgjuar për këtë buletin të lajmeve? Ide e shkëlqyer! Duhet ta dëgjoni. Do të dëgjoni lajme nga të gjitha rajonet e Kosovës. Nuk më kujtohet kur ka qenë hera e fundit që kam dëgjuar programe informative të mira këtu."

Edhe pse akoma nuk është shtrirë në veriun e Mitrovicës, rrjeti KOSMA mund të quhet storie e suksesshme. Tani, edhe radio stacionet në Hercegovinë dhe Mal të Zi ritransmetojnë programet informative të KOSMA-s dhe e sjellin Kosovën më afër fqinjve të saj.

## KOSMA

Fillimet janë gjithmonë të vështira. Kjo është përjetuar edhe në furrën e bukës me 10 metra katorë në një enklavë serbe në Kosovën Perëndimore. Qendra e fshatit përbëhet nga një shtëpi shëndeti, një kabinë për ushqim të shpejtë e sponzoruar nga BE-ja, administrata rajonale e UNMIK-ut e vendosur në një rimorkio, një radiostacion dhe një furrë buke (bukëpjekës). Në përgjithësi, një

Programi i ri, i quajtur KOSMA, sipas Shoqatës së Mediave të Kosovës i përbëre nga shumica e radiostacioneve serbe të Kosovës, është prodhuar nga katër transmetues të ndodhura në lokacione strategjike të cilët janë të lidhur në atë mënyrë që u lejon shkëmbim të pakufizuar të programeve dhe informatave.

Pasi që detyrat ndërrrohen çdo javë, njëra nga këto stacione është përgjegjëse për përpilimin e edicionit të lajmeve, e cila pastaj lidhet më një strukturë të lidhjes mikrovalore të dizajnuar në mënyrë specifike, e cila pranonhet nga transmetuesit tjere dhe transmetohet në të njëjtën kohë në mbarë Kosovën.

Ky është i vetmi program i lajmeve në radio në gjuhën serbe që iu ofron dëgjuesve lajme lokale, rajonale dhe nga bota, duke i lidhur kështu fshatrat e largëta dhe të mbrojtura si Gorazhdevci, me botën dhe fqinjët e tyre, si dhe i informon ata me ngjarjet politike dhe shoqërore në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinën.

Nevoja për projektin KOSMA ka ardhur pikërisht para zgjedhjeve të para parlamentare në vitin 2001 kur bashkësia ndërkombëtare kuptoi se nevojitej një radioprogram që do ta mbulonte krejt Kosovën për të përfshirë serbët e Kosovës në fushatën parazgjedhore dhe për t'i ofruar atyre informata të mjaftueshme në mënyrë që ata të mund të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse.

Misioni i OSBE-së në Kosovë është përgjegjës për edukimin dhe zhvillimin e policisë dhe të mediave. "Ne përpinqemi të përmirësojmë standartet e raportimit për krimin, të ngrisim vetëdijen e publikut për çështje të rëndësishme ligjore dhe policore, si dhe të vëmë në pah përfitimin nga raportet profesionale të punës në mes të policisë dhe mediave," tha Angela Tenbruck, Zyrتare nga OSBE-ja.

Gjatë viteve 2004 dhe 2005, Misioni ka implementuar një program për t'i ndihmuar mediat të familjarizohen me procedurat policore dhe të ngrisë mirëkuptimin e policisë për nevojat informative të mediave. Sipas Michael Schulte-Schrepping, Instruktur në Shkollën Policore të Kosovës, e cila udhëhiqet nga OSBE-ja, programi për Raportet në


mes të Policisë dhe Mediave ka përfshirë ushtrime teorike dhe praktike. Këto ushtrime u kanë shpjeguar gazetarëve se si policia kryen hetimet si dhe nevojën për të ushtruar vetëpërbajtje për të shmagur "kontaminimin" e vendit të ngjarjes apo pengimin dhe komprendimin e hetimeve. Policëve, në anët tjetër, u është shpjeguar nevoja për të dhënë informata dhe për të ndihmuar gazetarët në kryerjen e detyrave të tyre.

"Gazetarët dhe policët ishin në gjendje të testojnë njohuritë e fituara në vendet e improvizuara të ngjarjes," tha Z. Schulte-Schrepping.

Si pjesë e programit, OSBE-ja në tetor të vitit 2005 ka publikuar një doracak të madhësisë së xhepit me udhëzime të cilat gazetarët dhe policët duhet t'i ndjekin gjatë punës së tyre në rapport me njëritjetrin. Të marra nga kodet ekzistuese të mireselljes, ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, këto udhëzime informojnë policët dhe gazetarët dhe shkurtimisht iu shpjegojnë atyre se si të mirren me çështje si burimet konfidenciale, konfiskimi të materialit, qasjen në vendet e ngjarjes dhe mbrojtjen e të dhënave, në veçanti mbrojtja e të miturve, siç është përcaktuar në Kodin mbi Drejtësinë për të Miturit.

Më shumë se 13,000 kopje në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe angleze janë publikuar dhe janë duke iu shpërndarë policëve dhe gazetarëve në të gjitha komunitetet etnike.

Punëtorët e OSBE-së do të vizitojnë stacionet poliore dhe shtëpitë mediale nga 4 nëntori deri më 16 dhjetor të vitit 2005 dhe do të japid udhëzime në lidhje me këtë publikim. Udhëzime tanimë i



*OSBE-ja ka hartuar një doracak me udhëzime, duke i ofruar policisë dhe mediave një përbledhje të shkurtër të të drejtave të tyre themelore dhe obligimeve gjatë punës me njëri-tjetrin.*

janë dhënë edhe Zyrës së SHPK-së, duke u kthyer në Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës për kurse të avancuara të zhvillimit profesional.

Udhëzimet e hartuara nga Misioni i OSBE-së në vitin 2005 do të azhurohen nga palët vendore të interesit në vitin 2006 për t'i përgjigjur ligjeve të reja të miratuara për media dhe kode të mireselljes. Palët e interesit përfshijnë Këshillin për Media të Shtypura të Kosovës, Shoqatën për Media Elektronike, Shoqatën e Gazetarëve Profesionistë, Komisionin e Pavarur për Media, Radio Televizionin e Kosovës dhe Ministrinë e Ardhshme të Punëve të Brendshme/Inspektoriatin Policor.

## Radiotelevizioni shumëetnik 'Herc' arrin në mënyrë të sëksesshme deri te komënititetet

Komuna e Shtërpçës është një komunë mjaft e veçantë. Ka një pozitë të mirë gjeografike, institucionet e saj kanë strukturë të vërtetë shumëetnike, ka po ashtu edhe RTV Hercin, mjet informimi shumëetnik.

RTV Herc prodhon dhe transmeton program informativ dygjuhësor (në gjuhën serbe dhe shqipe) për dy orë e gjysmë çdo ditë. Iniciativa për të krijuar një medium të tillë ka ardhur nga Misioni i OSBE-së, qëllimi i së cilës ka qenë të përgatisë kuadro lokale mediale dhe të promovojojë program shumëetnik.

Nga dhjetori i vitit 2003 deri në gusht të vitit 2004, Misioni ka punuar me këtë stacion televiziv serb në Kosovë për të implementuar një projekt për zhvillimin e mediave dhe pajtimin. "TV Herci ka zgjeruar redaksinë e vet me gazetarë dhe teknikë shqiptarë dhe serbë si dhe ka përmirësoj.

Qëllimi i TV Hercit është të nxjerr në pah ngjarjet lokale të rëndësishme për të gjitha komunitetet e Shtërpçës. Është mediumi i parë në Kosovë që merr përsipër një detyrë të tillë.

OSBE-ja ka shkolluar, trajnuar dhe në fund ka mundësuar ekipin shumëetnik të TV Hercit – 3 shqiptarë dhe 10 serbe të Kosovës – të bashkëpunojë dhe së bashku të përgatisë lajme cilësore për shikuesit nga të dyja komunitetet. Sipas menaxheres së projektit në OSBE, Milosava Bansevic, Misioni po ashtu ka këshilluar televizionin dhe menaxhmentin e biznesit se si të formulojnë një plan biznesi dhe si të udhëheqin një stacion televiziv të vetëqëndrueshëm.

Modeli i suksesshëm i ndërveprimit shumë-etnik dhe pajtimit që ndodhi në TV Herc është i rëndësishëm jo vetëm për banoret e Shtërpçës por për tërë Kosovën dhe për komunitetet e ndryshme që jetojnë këtu, duke plotësuar zbrazëtirat informative dhe duke krijuar një ambient të favorshëm për porceset demokratike.

Kohëve të fundit, roli i Misionit të OSBE-së në TV Herc është krejtësisht i natyrës këshilluese. "Stafi i Misionit e viziton TV-në dhe ofron këshilla sipas nevojës," shtoi Banasevic.



*Ish-Shefi i Misionit të OSBE-së, ambasadori Pascal Fieschi, ka hapur zyrtarisht TV Hercin në korrik të vitit 2004.*

## ZGJEDHJET

shoqëror në të cilin zhvillohet. Në shoqëritë e pasluftës, siç është Kosova, ku marrëdhëniet ndëretinike ende janë çështje shumë të rëndësishme, ky aspekt vendimtar i ndërtimit të institucioneve dhe demokracisë, është dashur që të trajtohet në mënyrë shumë analitike dhe me ndieshmëri të madhe dhe për shumë interesa të ndryshme. Kjo tregon ku ka arritur Misioni i OSBE-së.

Misioni përqendrohet në dy sfida më të rëndësishme: ndërtimi i besimit në kornizën zgjedhore duke siguruar qëndrueshmëri dhe paanësi dhe duke formuar organe të pavarura, vendore, të cilat janë në gjendje të organizojnë dhe të udhëheqin zgjedhjet në të ardhmen.

Misioni i OSBE-së ka organizuar dhe mbikëqyrur të gjitha ciklet e zgjedhjeve në Kosovë – në nivelin komunal në vitin 2000 dhe 2002 dhe në nivelin qëndror në vitin 2001

dhe 2004. Të gjitha ishin vlerësuar si të lira dhe të drejtë, nga të dy palët vëzguese, vendore dhe ndërkombëtare. Sistemi zgjedhor që është përdorur ishte përfaqësimi i thjeshtë proporcional dhe me lista të myllura të partive politike, ku ulëset që janë fituar përafërsisht kanë reflektuar votën reale. Rregullat për çështje gjinore gjithashtu kanë siguruar që femrat të fitojnë ulëset. Për të siguruar përfaqësim



### Shtim i përgjegjësive për vendorët në mbajtjen e zgjedhjeve

Zgjedhjet e përgjithshme të vitit të kaluar, të mbajtura në tetor të vitit 2004, ishin të parat në të cilat OSBE-ja kishte filluar t'i dorëzojë përgjegjësitë operacionale në Sekretariatin e Komisionit Qendor të Zgjedhjeve. Kjo përfshinte aktivitetet që kishin të bënin me koordinim dhe planifikim në terren, subjekte politike dhe certifikim të kandidatëve, informim publik, akreditim të vëzhguesve dhe shpërndarje të materialit zgjedhor.

Sipas Lars Lagergren, drejtor i Departamentit të Zgjedhjeve, kjo kishte paraqitur një ndryshim të dukshëm pasi që OSBE-ja ndërronte fokusimin e vet në ngritje të kapaciteteve vendore, në mënyrë që të siguron që ky institucion të jetë në gjendje të organizojë zgjedhje të lira dhe demokratike në të ardhmen.

"Një transferim i përgjegjësive kishte kaluar nga stafi i OSBE-së tek nëpunësit civil. Sekretariati i KQZ-së ishte përgjegjës për planifikimin e nivelit qendor dhe së bashku me Komisionin Qendor të Zgjedhjeve ka kryer të gjitha operacionet në terren," shtoi ai.

minimal të minoritetave etnike në nivel qëndror, njëzet nga 120 ulëset në Kuvendin e Kosovës ishin të rezervuara për këto grupe.

Në vitin 2002 është formuar Grupi Punues i Zgjedhjeve me qëllim të shtimit të pronësisë mbi procesin zgjedhor. Ishte ky një forum konsultativ i organizuar dhe udhëhequr nga Misioni dhe përbëhej nga përfaqësuesit e forcave kryesore politike dhe civile. Ky organ i ka rekomanduar Përfaqësuesit të Posaçem të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së kornizën elektorale dhe proporcionale me lista të myllura për zgjedhje të përgjithshme në vitin 2004.

Për herë të parë në vitin 2004, Misioni i OSBE-së i ka dorëzuar përgjegjësitë kryesore operacionale autoritetit vendor për zgjedhje, të themeluar kohëve të fundit, kryesisht Komisionit Qendor i Zgjedhjeve (KQZ) dhe Sekretariatit të vet. Kjo shënon një hap përpresa për institucionet e Kosovës për të marrë përsipër pronësinë dhe manifestimin e angazhimit të OSBE-së që qytetarëve të Kosovës t'ua transferojë me sukses proceset zgjedhore.

KQZ-ja tash është në rrugën e vet që të bëhet organ i pavarur vendor, i aftë për të mbajtur operacione teknike efektive që rezultojnë në zgjedhje legjitime dhe të besueshme. Sekretariati është krah operativ KQZ-së që funksionon si institut jopolitik dhe shumëetnik. Do të jetë përgjegjës për menaxhim të të gjitha aspekteve teknike dhe operative për zgjedhjet e ardhme në Kosovë.

Për të siguruar pajtueshmëri të procesit zgjedhor me Rregulla Zgjedhore, KQZ-ja ka themeluar Nënkomisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP). Roli i KZAP-së është të gjykojë të gjitha ankesat dhe parashtresat që kanë të bëjnë me palët e interesit që marrin pjesë në zgjedhje dhe të cilat mund të paraqesin – votuesit, partitë politike, koalicionet, kandidatët, iniciativat qytetare, vëzhguesit, KQZ-ja, OSBE-ja dhe UNMIK-u.

Të krijuara në të njëjtën frysë si Grupi Punues i Zgjedhjeve, një Forum i Zgjedhjeve u formua në vitin 2005. Ky organ këshillëdhënës përbëhet vetëm nga kosovarët. Qëllimi i këtij organi është që të shqyrtohen rregullat ekzistuese për zgjedhjet komunale dhe përshtatja e tyre në kontekst specifik të Kosovës përmes organizimit të diskutimeve të hapura dhe transparente, duke marrë parasysh mësimet e marra nga zgjedhjet e fundit. Kjo e dhënë do të çojë në propozime konkrete për KQZ-në mbi kornizën e ardhme zgjedhore.

Misioni shpreson të marrë rol krejtësisht këshillëdhënës në Zgjedhjet e ardhshme të parapara për vjeshtën e vitit 2006. Në një hapësirë prej gjashtë viteve, Kosova do të trashëgojë nga OSBE-ja kornizën për të mbajtur zgjedhjet, sa po që të pranohet si sistem i qëndrueshmë, gjithëpërfshirës që ka ofruar bazë për të ardhme demokratike.



OSBE-ja ka qenë përgjegjëse për udhëheqjen e Qendrës për Numërim dhe Rezultate në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2004.

Misioni deri tash ka punuar për të ngritur vetëdijësimin e anëtarëve të KQZ-së për çështje shumë të rëndësishme, siç janë çështja gjinore dhe përfaqësimi i komuniteteve minoritare, përmes organizimit të trajnimeve. Kjo do të vazhdojë deri në vitin 2006 dhe me tutje për të ngritur kapacitetet e KQZ-së dhe Sekretariatit të vet.

Departamenti i Zgjedhjeve, megjithatë, nuk ka dalë plotësisht jashtë përgjegjësive. Përveç njohurive të veçanta që do të vazhdojë t'iu ofrojë institucioneve, do t'i mbeten në përgjegjësi edhe disa çështje sensitive. Këto përgjegjësi kanë përgatitur listën e votuesve, duke udhëhequr programin për votime për votuesit jashtë Kosovës, dhe planifikimin dhe mbajtjen e Qendrës për Numërim dhe Rezultate.

Përveç kësaj, OSBE-ja ka mbajtur zyrën për regjistrim të partive politike dhe revizion financiar.

Mirëpo, planet e OSBE-së për t'i dorëzuar të gjitha përgjegjësitë tek KQZ-ja dhe Sekretariati, janë për vitin e ardhshëm. Shpresohet që zgjedhjet komunale të vittit 2006 do të udhëheqen nga organi vendor për menaxhim të zgjedhjeve.

Në lidhje me legjisacionin për zgjedhje, Forumi i sapoformuar i Zgjedhjeve me përfaqësim të gjerë qytetar dhe politik do të bëjë rekomandime për KQZ-në që të aplikohen modelet më të mira në zgjedhjet e ardhshme komunale të vittit 2006.

## Forumi i Zgjedhjeve shënon fazën e re të dorëzimit të përgjegjësive

Forumi i Zgjedhjeve të Kosovës i mbështetur nga OSBE-ja, muajin e kaluar ka filluar punën për shqyrtimin e legjisacionit për zgjedhje dhe propozimin e rekomandimeve për përmirësimë të dukshme në sistemin zgjedhor.

Fillimi i aktiviteteve nga Forumi më 22 gusht, shënon një fazë të re në dorëzimin e përgjegjësive nga Administrata e Përkohshme e KB-së në Kosovë tek autoritetet vendore.

Forumi ishte formuar nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve (KQZ), për të shqyrtuar kornizën ligjore për zgjedhje të ardhshme. Zgjedhjet komunale të tertonit të vittit 2006 do të janë të parat që do të administrohen tërësisht nga autoritetet qendrore të Kosovës, që nga konflikti i vittit 1999.

Misioni i OSBE-së deri tash ka organizuar me sukses katër cikle të zgjedhjeve në Kosovë – zgjedhjet komunale në vitin 2000 dhe 2002, dhe zgjedhjet qendrore qeveritare në vitin 2001 dhe 2004. Gjithashtu, ka hartuar kornizën ligjore me të cilën janë qeverisur zgjedhjet.

### Ndihma organeve vendore përfunksionim të pavarur

KQZ-ja dhe Sekretariati janë dy organe vendore përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve. Misioni ka ndihmuar për të themeluar të dy organet (KQZ-në në vitin 2001 dhe Sekretariatin në vitin 2003) dhe ka punuar në ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që ato të funksionojnë në mënyrë të pavarur.

“Qëllimi ynë nuk është të organizojmë zgjedhjet, por të krijojmë organe vendore që do të kryejnë punët në të ardhmen. Ne dëshirojmë të dorëzojmë përgjegjësitë dhe të kemi një rol krejtësisht këshillëdhënës,” tha Shefi i Misioinit, Ambasadori Werner Wnendt, i cili po ashtu është edhe kryesues i KQZ-së.

Përgjegjësitë për zgjedhjet e fundit në Kosovë – zgjedhjet qëndrore administrative në teton të vittit 2004 – ishin ndarë mes Misionit dhe KQZ-së.

Misioni i kishte kryer aktivitetet që kanë të bëjnë me përpilimin e regjistratës së votuesve jashtë Kosovës dhe qendrës për numërim dhe rezultate, përderisa KQZ-ja kishte marrë përgjegjësitë përfundimtare për operacione tjera, siç janë çertifikimi i subjekteve politike, mbikëqyrja e zgjedhjeve, informimi publik e kështu me radhë.

Fillimi i punës nga Forumi nuk e shënon vetëm hapjen e kapitullit të ri, por edhe tërheq vëmendjen e mediave të dalluara, përfshirë një nga gazetat e përditshme të suksesshme në Kosovë, Koha Ditore.

“Qëllimi i Forumit është të shqyrtojë kornizën ligjvënëse zgjedhore dhe të formulojë rekomandimet për KQZ-në deri në mars të vittit 2006,” thuhet në gazetë.

“Forumi i zgjedhjeve është organi i vetëm që do të merret me ndryshimet e mundshme në sistemin zgjedhor. Do të bëjë propozimet e veta në kohë të duhur para zgjedhjeve komunale,” shton gazeta.

Forumi përbëhet nga 15 anëtarë: nëntë përfaqësues nga KQZ-ja, një nga ORA (iniciativë qytetare me shtatë vende në Kuvendin e Kosovës që apo është regjistruar si parti politike), një nga Ministria e Qeverisë Lokale dhe katër nga shoqëria civile.

### Sfidat para Forumit

Forumi është duke u ballafaquar me një numër sfidash, duke përfshirë:

- Njohjen me sistemin e listave të hapura ku votuesit do të votonin më parë për kandidatin se sa përfundimtare politike;
- Zgjedhjet e drejtëpërdrejtë të kryetarëve të komunave dhe
- Sigurimin e përfaqësimit të barabartë të gjinisë në fletëvotime dhe në përfaqësim në organet e zgjedhura dhe të emëruara.

Rekomandimet e bëra nga Forumi do të përdoren nga KQZ-ja në përcaktimin e formës së ardhshme të sistemit elektoral të Kosovës.

Me afatin e caktuar për muajin mars të vittit 2006, anëtarët e Forumit do të janë shumë të angazhuar në gjashtë muajt e ardhshëm. Gjatë asaj kohe, Misioni i OSBE-së do të ofrojë këshilla të nevojshme përfundimtare për të përfunduar aftësinë e institucioneve përfundimtare përsipëri detyrat e tyre në administrimin e Kosovës.



Forumi i Zgjedhjeve është një organ tërësisht vendor me 15 anëtarë vendorë në radhët e tij, të cilët përfaqësojnë partitë politike dhe organizatat joqeveritare.



*Legjislacioni pér zgjedhje, i cili do tē hartohet nga Forumi i Zgjedhjeve që do t'i sygjerohet KQZ-së, do tē ndikojë nē masë tē madhe nē udhëheqjen e zgjedhjeve tē ardhshme nē Kosovë.*

### Organet vendore aministrojnë zgjedhjet nē nivel lokal

Me qëllim tē krijimit tē mundësisë pér mbajtjen dhe organizimin e zgjedhjeve transparente dhe tē drejta me pronësi vendore, OSBE-ja dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, qysh nga nē vitin 2000, kanë themeluar Komisionet Komunale tē Zgjedhjeve (KKZ), tē udhëhequra nga një Zyrtar Ekzekutiv Komunal (ZEK), nē secilën nga 30 komunat e Kosovës. Këto organe përbëhen nga tre gjegjesishte pesë përfaqësues vendor, tē cilët ndihmuant nē çështjet administrative tē zgjedhjeve. Edhepse KKZ-të ishin themeluar vetëm gjatë periudhave tē zgjedhjeve, posti i Zyrtarit Ekzekutiv Komunal është një positi e përhreshme nē Kuvend Komunal.

Përgjegjesitë e KKZ-ve kishin tē bënин me një numër detyrash, siç ishin këshillimi i partive politike si dhe entiteteve tjera pér tē drejtat dhe obligimet e tyre si dhe tē sigurohen se aktivitetet nē vendvotime do tē shkojnë qetë. Ata gjithashtu kanë ndihmuar nē emrin dhe trajnimin e stafit tē vendvotimeve; u perkujdesen pér tē gjitha përgaditjet teknike dhe kanë siguruar mbarvajtjen e vitomit, numrimin si dhe përgaditjen e rezultateve zgjedhore nē vendvotime.

Sipas z. Lars Lagergren, drejtor i departamentit tē Zgjedhjeve nē Mision, Komisionet Komunale tē Zgjedhjeve u dëshmuant si shumë tē suksesshme dhe punuan nē bashkëpunim me qendrat e votimit.

Komisionet Komunale tē Zgjedhjeve kanë qenë kryesisht jopolitike. Legjislacioni nē zbatim siguronte që përfaqësuesit e entiteteve politike apo aktivitetet e tyre tē mos ishin tē pranishme nē Komisione. Pér më tepér, KQZ-ja kishte tē drejt ti largonte antarët e KKZ-ve poqeëse vertetohej se kishin vepruar nē mënyrë tē njëanshme apo joprofessionale.

Në raste tē veçanta, kur ishte vendosur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, numri i anëtarëve tē Komisioneve Komunale tē Zgjedhjeve është ngritur pér tē siguruar përfaqësim tē drejtë tē pakicave.

Komisionet Komunale tē Zgjedhjeve paraqesin një element vital nē ngritjen e kapaciteteve, që është interes thelbësor i mandatit tē OSBE-së. Këta zyrtarë civil tē specializuar, gradualisht do tē bëhen qendër e proceseve zgjedhore nē tē ardhmën.



*Komisionet Komunale tē Zgjedhjeve janë drejtperdrejt përgjegjëse pér udhëheqjen e ekipeve nē vendvotime.*



## Roli i Misionit të OSBE-së në Kosovë në vitin 2006

Me fillimin e procesit për definimin e statusit të ardhshëm, Kosova po ballafaqohet me një mori vendimesh. Sidoqoftë, kjo nënkupton edhe përcaktim të sistemeve të saj politike dhe ligjore si dhe sistem ekonomik funksional dhe stabil. Viti 2006 do të jetë vit vendimtar sa u përket këtyre çështjeve.

Për më shumë se gjashtë vjet, Misioni i OSBE-së ka funksionuar në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe vendimit nr. 305 të Këshillit të Përherershëm të OSBE-së. Si pjesë e veçantë e Administratës së Përkohshme të OKB-së, Misioni i OSBE-së në Kosovë është marrë me çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit brenda Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ); ka ndihmuar krijimin e sistemit ligjor, transmetuesit publik, forcës policore, si dhe ka këshilluar në lidhje me legjisacionin; të gjitha këto janë kushte para-prake për bisedat për statusin e ardhshëm.

Sido që të jetë, sfidat gjatë bisedimeve për status dhe pas zgjidhjes politike, do të kenë ndikim në degën e legjislativit dhe ekzekutivit të qeverisë, si dhe në gjyqësorin e Kosovës, për të mos përmendur shoqërinë si tërsësi. Këto ndryshime do të ndikojnë në masë të madhe te njerëzit që jetojnë në Kosovë, të cilët do t'i japid formë realitetit të tyre të ri, pa marrë parasysh rezultatin e bisedimeve për statusin e ardhshëm.

Edhe roli i pranisë ndërkontinentale në Kosovë do të marrë formë të re dhe kjo mbetet të përcaktohet në të ardhmen. OSBE-ja është duke bashkëpunuar ngushtë me Bashkimin Evropian dhe Kombet e Bashkuara si dhe me IPVQ-të, për hartimin e planeve të ardhshme në secilën fushë të politikave.

Tani, më shumë se gjatë viteve të kaluara, OSBE-ja do të ndryshojë, por edhe do të kërkohet nga ajo që të tregojë fleksibilitet gjatë ballafaqimit me sfidat që e presin në të ardhmen. Mandati i saj do të rishikohet por OSBE-ja pret të kalojë nga roli i saj i themelimit dhe zhvillimit të institucioneve dhe legjisacionit në rolin e monitoruesit dhe këshilluesit për homologët e saj në Kosovë.

Nga fillimi i vitit 2006, Misioni i OSBE-së do të punojë sipas një strategji të monitorimit proaktiv. Kjo nënkupton se organet vendore, në veçanti IPVQ-të, do të inkurajohen që të marrin masa parandaluese dhe vetëkorrigjuese në punën e tyre, për të siguruar se praktikat e tyre përpunohen me praktikat e pjesës tjetër të Evropës.

Për të qenë të efektshëm në një rol të këtillë të monitoruesit, ne në OSBE duhet të jemi të pranishëm në secilën nga tridhjetë komunat e Kosovës dhe pilot-njësitet komunale, për të ndihmuar institucionalizimin e "praktikave më të mira" ekzistuese të qeverisjes së mirë. Më konkretisht, një element i ri i aktiviteteve të Misionit do tëjenë 'Ekipet komunale', të cilat do të punojnë në nivel komunal në partneritet me institucionet komunale dhe Departamentin e Administratës Civile pranë OKB-së në Kosovë.

Bashkëpunimi me institucionet qëndrore të IPVQ-ve do të vazhdojë me po të njëjtin intensitet.

Puna jonë në Kosovë do të paraqesë një shkallë më të avancuar të rehabilitimit post-konfliktual, përmes së cilës, OSBE-ja do të rrissë angazhimin e saj me autoritetet në të gjitha nivelet, për çështjet siç janë: qeverisja e mirë, respektimi i të drejtave të njeriut dhe sundimi i ligjit. Një trend i tillë, tashmë, shihet në vendet të cilat me ndihmën e OSBE-së ose kanë hyrë ose janë duke hyrë në proceset integruese evropiane.

Parimet evropiane janë forca shtytëse në qeverisjen e Kosovës. Kosova duhet të vazhdojë të shkojë përpara në agjendën e saj evropiane, që do të thotë të punojë për standarde. Ideali evropian është: demokracia bazohet në njerëz dhe nuk ka diskriminim në mes tyre.

Në thelb, përqendrimi jonë në vitin 2006 dhe më pas, do të jetë bërrja e një sistemi demokratik dhe një shoqëri shumëetnike në Kosovë; vlera të cilat do tëjenë të vetëqëndrueshme dhe që do tëjenë në gjendje t'iu përgjigjen nevojave të popullit. Kjo do të thotë qeveri dhe gjyqësor transparent dhe të efektshëm, respekt për të drejtat e njeriut për të gjithë dhe respektim të sundimit të ligjit.

Dëshira për të vazhduar prezencën e Misionit të OSBE-së në fazën pas konfliktit, është indikator i quartë i përkushtimit të Organizatës për Kosovën dhe popullin e saj. Ne jemi të bindur se nëse punojmë së bashku dhe nëse popullata dhe autoritetet vendore e shfrytëzojnë prezencën e OSBE-së, do të mund të arrijmë progres të madh drejt normalizimit të jetës në Kosovë, ashtu që njerëzit të mund të përqendrohen në punën e tyre, për të krijuar mirëqenie më të mirë përfamiljore.

Krijimi i një gjendjeje të tillë kërkon përfshirjen aktive të njerëzve në këtë kohë të ndryshimeve. Misioni i OSBE-së në Kosovë është partner i gatshëm i cili nuk do të heqë dorë nga parimet e veta sipas të cilave të drejtat e njeriut dhe demokracia janë për të gjithë – parime që mund të gjenden kudo në hapësirat e OSBE-së – nga Vankuveri, Kanada e deri në Vlladivostok, Rusi.

Në këtë drejtim, OSBE-ja është duke ofruar gurthemelin; bazën për një të ardhme evropiane të Kosovës.